



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 16.09.2016, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Vazhdimi i shqyrtimit të projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë.”

**Marrin pjesë:**

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Pandeli Majko, Vasilika Hysi, Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Keltis Kruja, Arben Ristani, Petrit Vasili, Vexhi Mucmataj, Aldo Bumçi.

**Mungojnë:**

Spartak Braho, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu

**Të ftuar:**

Arben Rakipi – Ekspert i Nivelit të Lartë

Artan Hoxha - Ekspert i Nivelit të Lartë

Korajlka Bumçi – Eksperte e Nivelit të Lartë

Adnan Xholi – përfaqësues nga Prokuroria e Përgjithshme

## HAPET MBLEDHJA

**Fatmir Xhafaj** – Mund ta hapim mbledhjen e komisionit.

Në rendin e ditës kemi projektligjin “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë.”

Mbledhja ishte parashikuar në orën 11:00, por ramë dakord të gjithë për ta shtyrë një orë, për t’u njohur edhe me opinionin e kolegëve të opozitës, lidhur me përmbajtjen e projektligjit, në mënyrë që gjatë debatit të jemi të gjithë më të qartë se për çfarë do të diskutojmë dhe për çfarë do të debatojmë.

Relator është zoti Manja. Ekspertët vendas dhe ndërkombëtarë, së bashku me sekretariatit teknik, që kanë sjellë projektin, janë të pranishëm: zonja Bumçi, zoti Hoxha, zoti Rakipi.

Zoti Bylykbashi, urdhëroni!

**Oerd Bylykbashi** – Zoti kryetar, kam vetëm një çështje procedurale. Ndërkohë që është punuar, pra, ekspertët kanë punuar, ne kemi punuar, meqenëse shikoj të pranishëm edhe përfaqësues të prokurorisë së Përgjithshme përtej asaj që ata mund të kenë kontribuar në proces gjatë kohës që është hartuar ligji, mund të kenë çështje të karakterit teknik, të cilat ne nuk i kemi parë, gjykoj se mund të jenë pjesë e vlefshme e diskutimit tonë me sugjerimet për të përmirësuar aspektet teknike të këtij ligji.

Sigurisht, çështjet e karakterit politik në lidhje me atë se si mendojmë ne që duhet të zbatohet Kushtetuta janë pjesë e këtij komisioni, por për të garantuar që është maksimumi i përfshirjes së opinionit teknik, gjykoj se do të ishte me vlerë kontributi i tyre për të marrë pjesë në diskutim në çështje të caktuara dhe në nene të caktuara.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit, për ndërhyrjen tuaj! Mendoj se është një ndërhyrje e panevojshme dhe e papranueshme, për një arsye të thjeshtë. Përfaqësuesit e prokurorisë janë thirrur nga ana ime vetëm për efekt të shqetësimit që ka pasur kohët e fundit prokuroria për dispozitat transitorë, sepse kjo nuk është një mbledhje me grupet e interesit, nuk është as një seancë dëgjimore. Këtu është thjesht shqyrtimi i projektligjit dhe gjatë shqyrtimit të tij marrin pjesë deputetët dhe hartuesit ose mbrojtësit e projektit.

Gjithsesi, nëse ka diçka, mund ta ngrenë dorën në një moment të caktuar për një gjë që është vërtet shqetësuese, në mënyrë të veçantë për pjesën e dispozitës transitorë nëse ka nevojë. Megjithatë kjo u trajtua dje, u mor edhe mendimi i tyre dhe ishin dakord. Ky është thelbi i kërkesës. Ka qenë kërkesa ime drejtuar prokurorit të Përgjithshëm që të ishin të pranishëm posaçërisht vetëm për këtë gjë.

Urdhëroni!

**Keltis Kruja** – Zoti kryetar,

Unë mendoj se përderisa përfaqësuesit e Prokurorisë së Përgjithshme i kemi këtu dhe për shkak se ne nuk kemi qenë të pranishëm në momentet kur ju pretendonit që ata i kanë paraqitur problematikën e tyre të ligjit “Për prokurorinë”, pra, ky komision i ka zhvilluar punimet pa praninë e opozitës, mendoj se do të ishte shumë e vlefshme për ligjin në përgjithësi, pra, për teknikalitetet që përmban ligji jo për çështjet politike për të cilat diskutojmë ne si deputet, të dëgjonim edhe opinionin e tyre. Nuk ka asgjë të keqe. Nuk po kërkojmë të bëhen palë në proces, megjithatë, për mua, përderisa është ligji “Për prokurorinë”, nuk kemi pse të mos i dëgjojmë mendimet e përfaqësuesve të Prokurorisë së Përgjithshme.

**Fatmir Xhafaj** – Edhe një herë faleminderit, por mua po më çudisni vërtet! Po të ishit aq të interesuar, e kishit kërkuar në fillim që të ishin të pranishëm, ta dëgjonit prokurorinë.

Sot ju thashë, ka qenë kërkesa ime për prokurorin e Përgjithshëm vetëm për shqetësimin që ata kanë ngritur dhe që të jenë të pranishëm. Këtu fillon dhe mbaron. Kjo nuk është një seancë dëgjimore me grupet e interesit dhe institucionet. Është e kotë që bëni diskutim për këtë gjë.

Unë e kuptoj shumë mirë që ju doni të nxirrni dhjam nga pleshti, por në këtë rast nuk arrini dot.

**Oerd Bylykbashi** – Zoti kryetar,

Besoj se në vazhdim të asaj që kam thënë edhe dje në mbledhje është e kotë që ne t'i shtojmë komente njëri-tjetrit pse, qysh dhe tek, vjen nga pleshti ose jo.

Kjo nuk është seancë dëgjimore. Kjo është një seancë që do të ndajë gjëra shumë të rëndësishme, mënyrën se si do të funksionojë prokuroria, ndoshta edhe për shumë gjatë.

**Fatmir Xhafaj** – Nuk kanë ardhur me këtë status, zotëri!

**Oerd Bylykbashi** – Dakord. Ne e dimë shumë mirë që në këto lloj ligjesh, në këto lloj procesesh shpeshherë djalli është te detaji. Nëse ngecim do t'ia vëmë fajin presjes. Ne të gjithë

kemi eksperiencën tonë nga puna që kemi bërë, që kemi ngecur për presje, për numërtim të pabërë paragrafësh. Për fat, kemi ish-prokurorë në përbërjen e këtij komisioni, por edhe mund të mos e kishim fare. Ama me gjithë përpjekjen tonë qoftë ne si deputetë, qoftë ekspertët e nderuar, mund të na shpëtojnë gjëra që janë të përditshmërisë së punës që hasim sot, teknikalitete të neneve të caktuara.

Megjithatë unë dëgjova diçka nga kryetari që tha se për çështje të rëndësishme mund ta ngrenë dorën dhe të flasin. Ky është mirëkuptimi. Besoj se vlen.

**Fatmir Xhafaj** – Unë nuk e kuptoj, jam unë që i kam ftuar. Unë kam kërkuar të jenë të pranishëm. Ju tani dilni avokatë të mi?! Këtë nuk po e kuptoj dot.

Zotëri, i kam thënë për këtë gjë dhe u kam thënë: Ju lutem, meqenëse e keni pasur këtë shqetësim, po shqyrtojmë projektligjin, ndoshta edhe ne kemi nevojë, kur të vijë çështja për dispozitat transitorë, të jeni të pranishëm.

**Oerd Bylykbashi** – Sot keni marrë një opinion të Partisë Demokratike. Përpara se të hyjmë në diskutimin nen për nen, besoj se vlen të parashtrihen shkurtimisht çështjet kryesore, ato që ne i konsiderojmë çështje të karakterit sistemik të ligjit. Nen për nen do t'i shikojmë rast pas rasti.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

**Oerd Bylykbashi** – Çështja e parë që ne ngremë ka lidhje me rregullat e organizmit të brendshëm të organit të prokurorisë. Është kreu 5 dhe 6 i projektligjit.

Në gjykimin tonë, dhe kjo është një nga çështjet kryesore sistematike, që besoj se ne do ta vuajmë, ndoshta edhe për shkak të mënyrës që është konceptuar gabim në Kushtetutë, është roli i prokurorisë.

Ne e kemi arritur me një sukses për t'u mos dëshiruar, të krijojmë një prokurori të Çështjeve të Përgjithshme dhe një prokurori për Çështjet e Posaçme. Kemi bërë diçka që nuk është fare çudi që në një kohë shumë të shpejtë të na fillojë të na prodhojë probleme, konflikte brenda sistemit dhe derisa të na duhet t'i zgjidhim do të na marrë kohë.

E gjithë kjo do të penalizojë efikasitetin e punës së Prokurorisë së Çështjeve të Përgjithshme. Një nga gjërat më të dëmshme që po bëjmë, dhe kjo vazhdon e të theksohet edhe më fort në projektligj, është fakti që prokuroria është konceptuar jo si fragmentizim, por si një atomizim i mënyrës si funksionon, të raporteve që ka brendapërbrenda saj. Është shkuar drejt një ekstremi në pavarësinë individuale të prokurorëve dhe kjo ka dy risqe.

Së pari, do të kemi një prokurori shumë amorfë. Askush nuk do të marrë vesh në fund se çfarë do të bëjë, askush nuk do të japë llogari deri në fund për atë që bën dhe si e bën, do të ndryshohen urdhrat që do të jenë pa vlerë dhe në fund do të kemi një prokurori të ngritur me ishuj brendapërbrenda, të cilët do të çojnë në ulje drastike, në këndvështrimin tonë, të efikasitetit të këtij organi që është themelor, sepse ky merret me të gjitha gjërat e tjera, që nuk janë krim i organizuar dhe korrupsioni dhe që ia kemi lënë prokurorisë speciale.

Thënë kjo, përveç këtij dëmi të madh sistemik që do të kemi në të ardhmen, kjo është bindje dhe e kemi thënë më herët dhe do ta shohim shpejt këtë lloj ushtrimi në gjykimin tonë, por kjo rrit rrezikun në mënyrë të skajshme për kapjen nga jashtë sistemit të individëve, që kanë një pavarësi brendapërbrenda, të një sistemi që nuk ka asnjë lloj hierarkie qoftë edhe të dobët, dhe prokurorët në këtë mënyrë ekspozohen shumë ndaj kontrollit nga jashtë, përfshirë kontrollin politik.

Pra, rritet vulnerabiliteti i sistemit në mënyrë të skajshme dhe kapja e tij nga jashtë. E thashë, rrënja është në Kushtetutë dhe përkeqësohet më shumë në mënyrën si po parashikohet në këtë ligj.

Sot ne e themi këtë, kemi aq mend dhe aq eksperiencë për ta kuptuar se çfarë po themi. Kur të vijë prova do të jetë shumë vonë. Prova do të na çojë te ndryshimi i ligjit dhe eventualisht i Kushtetutës.

Sigurisht që eksperiencat tona i kemi, i dimë hallet tona. Jo çdo lloj eksperience është eksperiencia më e mirë që mund të vijë dhe ta implantojmë. Rreziku i parë i madh është që ne do të kemi një prokurori, e cila nuk do të jetë koherente në mënyrën si funksion dhe prodhojë me pasoja mbrapa.

Çështja e dytë ka të bëjë me kompetencat e prokurorit të Përgjithshëm.

Prokurori i Përgjithshëm është kthyer në një staticien. CEO i një korporate mesatare ka më shumë pushtet brendapërbrenda organizatës së saj sesa prokurori i Përgjithshëm.

Pra, prokurori i Përgjithshëm, me sa duket, me një dizenjo shumë të ngushtë në kokë është hartuar si një arkitekturë që nesër do të kushtojë. Prokurori i Përgjithshëm është me vlerë shumë të vogël në sistem. Nuk është në gjendje që as edhe ato udhëzime, që mund të japë, nuk i kontrollon dot më zbatimin e tyre. Thjesht është një funksion, i cili do të mbledhë të dhëna në funksion të raportimit vjetor qoftë edhe herë pas here kur të kërkohet nga parlamenti. Por që të japë ai llogari se çfarë po ndodh me krimin e organizuar dhe me korrupsionin nuk e bën dot,

sepse prokuroria e posaçme nuk e pyet fare. Ndërkohë, është i vetmi organ i ndjekjes penale, i cili i jep llogari politikisht para parlamentit. Zero. Është një brilancë aventurore. Më keq do ta bëjmë dhe më keq akoma e investojmë parlamentin e Shqipërisë në një zgjedhje me një shumicë të cilësuar, 2/3-at në fillim, 3/5-at më pas. Për çfarë? Për dikë që është më pak se CEO i një korporate mesatare. Vendi futet në një krizë politike apo në një marrëveshje politike, që janë edhe me dyer të mbyllura ndonjëherë, për të zgjedhur këtë individ, i cili nuk ka peshë në sistem.

Ekspertë të ndryshëm mund të ndajnë ide të ndryshme, por ajo që do të ndodhë është se do të kemi një prokurori, e cila nuk do të ketë as kokë dhe për rrjedhojë duke qenë e fragmentuar, do të jetë edhe më e dobët.

Sigurisht, nëse shpata thyhet ose nëse është e butë, atë rol që ka për të kryer, nuk ka për ta bërë dot, por ndoshta meqenëse është konceptuar që do të jetë një prokurori, që nuk do të merret me krimin e organizuar është menduar që mund të jetë edhe e butë.

Lidhur me kriteret për emërimin e prokurorit të Përgjithshëm ne mendojmë se mënyra si janë konceptuar kriteret të cilët nuk vlerësojnë nuk i japin peshë të madhe eksperiencës praktike, por kryesisht tek titujt dhe formimit akademik, mënyrës si është konceptuar metodologjia e renditjes së kandidatëve. Duke i dhënë diskrecion shumë të madh Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nesër do të çojë në selektivitet. Pra, në momentin kur të fillojë të funksionojë, ky ligj do të çojë në atë që Këshilli i Lartë i Prokurorisë tashmë i ndikuar në një raport shumë më të madh nga jashtë, sepse raporti është 6 me 5, kemi një mundësi që ndikimi nga jashtë në përzgjedhjen e prokurorit të jetë i tillë që mund të çojë në një selektivitet politik. Nuk besoj se ky është qëllimi qoftë edhe e kësaj Kushtetute me gjithë hallet dhe problemet që ka. Sigurisht, edhe ky organ duhet të jetë po aq i pavarur sa edhe prokuroria e posaçme.

Për sa u përket marrëdhënieve me institucionet e tjera prokurori i Përgjithshëm përcaktohet si përgjegjës për mënyrën dhe masën e respektimit të udhëzimeve të përgjithshme të dhëna prej tij, sipas rekomandimeve të Këshillit të Ministrave, ndërkohë që nuk i njihet instrumenti i kontrollit ndaj prokurorëve më të ulët lidhur me zbatimin e tyre. Ky funksionar nxjerr udhëzime dhe nuk i kontrollon dot.

Ndërkohë, shqetësim tjetër i madh lidhet me marrëdhëniet që projektligji përcakton midis prokurorit të Përgjithshëm dhe ministrit të Drejtësisë, ku është lënë në gjykimin tonë, një mundësi e fshehur për ministrin e Drejtësisë për të kryer inspektive. Mënyra si është hartuar lë

vend për ta interpretuar nesër në praktikë që ministri i Drejtësisë t'i njihet e drejta e kontrollit ndaj prokurorit. Ndërkohë që vetë prokurori i Përgjithshëm këtë nuk e bën dot.

Sigurisht, kemi edhe situata ku prokurori në nivel më të ulët se prokurori i Përgjithshëm mund të japë udhëzime konkrete për çështje konkrete, e cila shkon në cenim të pavarësisë së prokurorit. Ndërkohë, prokurori i Përgjithshëm nuk është në gjendje të kontrollojë as zbatimin e udhëzimeve të tij të përgjithshme.

Gjithashtu, gjykojmë se përtej asaj që duhet të jemi të bindur se zgjidhja me dispozitë transitore në ligjin e djeshëm për prokurorinë e posaçme, të jetë e mjaftueshme, të shikojmë nëse është e nevojshme nëse këtu duhet të rregullojmë diçka shtesë për ta kopsitur përfundimisht këtë fazë kritike tranzitore.

Gjithashtu, na duhet një dispozitë transitore që të rregullojë funksionimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në këtë fazë të parë. Gjykojmë se ligji këtë nuk e ka dhe duhet ta garantojmë këtë tranzicion që krijojnë ndryshimet kushtetuese.

Pika e fundit që është çështja për vlerësim rast pas rasti, ne e kemi thënë gjithmonë që çështjet me karakter teknik që i vlejné mënyrës si është shkruar ligji, mënyrës si ai do të funksionojë në detaje, koherencës, mungesës së boshllëqeve që ai duhet të ketë që pastaj kanë të bëjnë më pas me stabilitetin e legjislacionit, çështje që në vetvete, sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese marrin relevancë kushtetuese, këto janë çështje që ne kemi bërë komente dhe mbetet ta vendosë komisioni dhe më pas parlamenti për t'i pranuar ose jo, por përgjegjësia mbetet e parlamentit, e maxhorancës që do ta votojë, nëse nesër problemet teknike do të prodhojnë ngërçe në zbatimin e përditshëm.

Ky ishte parashtrimi i pikave kryesore që ne kemi. Nuk e di nëse ndonjë koleg ka ndonjë çështje tjetër. Më pas do të flasim nen për nen për elemente të caktuara.

**Fatmir Xhafaj** – Zoti Majko, urdhëroni!

**Pandeli Majko** - Ne sot kemi lënë për të diskutuar ligjin nen për nen.

Kemi thirrur përfaqësuesit e prokurorisë që të japin opinionet e tyre për çdo nen. Mirë është që askush nga ne këtu të mos marrë përsipër të flasë në emër të tyre.

E dyta, zotërinj, derisa keni votuar me dorën lart të gjitha nenet e Kushtetutës, përfshi edhe kompetencat e prokurorit të Përgjithshëm, kam parasysh nenin 100, duke filluar nga 148-ta deri në vazhdim, po specifikisht meqenëse folët për kompetencat e prokurorit të Përgjithshëm duke thënë që është as më pak e as më shumë, sa një CEO në një korporatë etj. etj., neni 148/b

është e zeza mbi të bardhë. E kemi votuar së bashku me 140 vota, prokurorit të Përgjithshëm janë dhënë këto kompetenca, vetëm po i citoj: a, b, c, ç, d, dh. I kemi votuar.

Çfarë na diskutoni këtu tani? Çfarë teme doni të hapni? Doni të më thoni se jeni penduar për kompetencat që keni votuar në Kushtetutë?! Doni të na thoni të zinj të ju, se çfarë mund të ndodhë pas 6 muajsh dhe të jetë e shkruar kjo në procesverbal?! Shkruajeni në ndonjë editorial, zotërinj dhe botojeni në medie! Mos hajdeni këtu të na bëni leksione!

Shkoni dhe mbani një leksion, sepse kemi edhe dekanin e Fakultetit Juridik këtu, si mund të bëhet një reformë drejtësie pa qeverinë, pa institucionet që emërohen nga qeveria! Shikoni si do të reagojnë studentët! Mos na bëni leksione të kësaj natyre!

Unë propozoj të diskutojmë projektligjin nen për nen.

**Fatmir Xhafaj** – Zoti Bylykbashi.

**Oerd Bylykbashi** – Zoti kryetar, më bëri një pyetje zoti Majko. Do të shkojmë te diskutimi nen për nen, mos u shqetësoni!

**Fatmir Xhafaj** – Nuk ka kuptim. Ju vini thjesht të na acaroni nga nervat!

**Oerd Bylykbashi** – Më falni, një sekondë! Ne jemi dy palë të barabarta në këtë komision dhe nuk i acarojmë askujt nervat.

**Fatmir Xhafaj** - Po mban një apologji...

**Oerd Bylykbashi** – Zoti Majko, arsyeja pse është votuar me 140 vota është shumë e qartë. Çështjet minimale politike që garantojnë moskapjen e sistemit të drejtësisë nga maxhoranca qeverisëse u arrit të mbylleshin, por kjo nuk u heq asnjë presje të gjitha vërejtjeve që kemi bërë për aspektin sistematik me shumë probleme që kanë shumë aspekte, duke filluar qoftë nga arkitektura, që mbeti e cunguar më pas.

Ne kemi një këshill të emërimeve në drejtësi që është një *zombi* kushtetues praktikisht dhe probleme të tjera. Në vetvete duke qenë se ky është një sistem brenda sistemit ka probleme. Këtë e kemi thënë dhe nuk tërhiqemi nga kjo pjesë.

Kjo do të thotë që nesër kur t'ju mbushet mendja do ta ndërrojmë bashkë këtë pjesë.

Zoti Majko, arsyet pse ne i ngremë ato çështje që janë thënë me shkrim i përsërisim sot. Ne e kemi lexuar dhe jemi të shqetësuar. Zgjidhe me veten kur nuk e lexon Kushtetutën.

**Fatmir Xhafaj** - Zoti Bylykbashi dhe kolegë, zgjidhjet e mëdha janë zgjidhjet kushtetuese. Është votuar konsensualisht nga 140 deputetë. Ju e kemi votuar me zemër të thyer,



kjo është një gjë e njohur. E keni votuar pa vullnet, pa dëshirë. Keni qenë të detyruar dhe sot i ktheheni përsëri të njëjtës histori.

Çfarë kuptimi ka për një që kemi bërë zgjidhje kushtetuese? E ka Kushtetuta se si duhet të jetë. Ai diskutim është mbyllur.

Tani diskutojmë si këtë normë kushtetuese e jetësojmë në ligj dhe si ligji të jetë në pajtim me Kushtetutën dhe këtu fillon dhe mbaron diskutimi ynë. Të gjitha diskutimet e tjera janë provokime politike që bëhen këtu dhe nuk është korrekte, mendoj unë.

Për sa i përket kësaj çështjeje është e zgjidhur. Janë dy filozofi të ndryshme. Ju jeni për zyrtarin e fuqishëm që sundon prokurorinë dhe që e emëron dhe e kontrollon politika. Kushtetuta është për prokurorin zot, prokurorin e fuqishëm dhe prokurorin e Përgjithshëm, që është një administrator, një drejtues i sistemit në respekt të Kushtetutës dhe të ligjit. Janë dy filozofi këto.

Me Kushtetutën ka fituar filozofia që nuk ka një njeri-Zot që kontrollon sistemin të cilin e kontrollon politika, por ka një njeri që vjen nga radhët e prokurorëve, që e zgjedhin prokurorët, që i japin peshë prokurorisë dhe prokurorit. Kjo është mbyllur.

Tani jemi te ligji konkret. A diskutojmë për ligjin konkret, sesi është i gjithë ky parashikim kushtetues i përkthyer te ligji? Ne kemi dashur të mos bëjmë shumë debate politike.

**Keltis Kruja** – Për ta lexuar ligjin ne e dimë shumë mirë se cila palë ka votuar pa e lexuar, sepse e keni bërë edhe deklaratë publike, por kjo nuk ka rëndësi. Tani provokime politike po bëni ju dhe jo ne.

Ne po diskutojmë për ligjin që kemi përpara. Po shprehim pikëpamjet tona të cilat i keni edhe të shkruara. Për këtë u shty edhe mbledhja. Në qoftë se ne kemi dalë jashtë atyre që kemi depozituar procesverbalet aty i keni dhe i lexojmë.

Në qoftë se ju thoni se jeni më mirë pa ju në komision, sepse praktikisht këtë thatë, komisioni është juaji, ne vijmë sa për t'ju acaruar, nuk besoj se është detaj teknik. Ky është provokim politik, më duket.

Në qoftë se ju thoni se ndahemi në filozofi të qarta me ligjin, po ju them se nëse prokurori i përgjithshëm anihilohe si pozicion, krijohen disa prokurorë të përgjithshëm, që janë drejtuesit e prokurorisë nëpër rrethe, sepse sipas këtij ligji dhe sipas kësaj filozofie që heqim një autokrat, ne themi që prokurori i Përgjithshëm nuk ka asnjë kompetencë të ndërhyjë për çështje konkrete apo të japë mendim...

**Fatmir Xhafaj** – Ia ka dhënë Kushtetuta.

**Keltis Kruja** – Ta përfundoj. Pastaj e citon përsëri, Pandi, Kushtetutën.

Drejtuesi i prokurorisë thotë, ka të drejtë të ndërhyjë te prokurori i thjeshtë për çështje konkrete. Pra, decentralizimi këtu shkon deri te drejtuesi i prokurorisë në rreth. Nuk shkon te prokurori i thjeshtë. Pikërisht, për këtë po themi për parimin e decentralizimit për të cilin ju jeni shumë të shqetësuar që t'i heqim...

**Fatmir Xhafaj** – Nuk e keni kuptuar. Është krejt e kundërta. Ta siguroj këtë gjë.

**Keltis Kruja** – Sqaroje pasi të përfundoj.

**Fatmir Xhafaj** – Nuk kam se çfarë të sqaroj. Është në ligj. Duhet të ta lexoj ligjin ty, por nuk është detyra ime kjo.

**Keltis Kruja** – Mos më ndërprit kur flas! Pikërisht për këtë, ne kemi paraqitur këto konsiderata të përgjithshme mbi të cilat po diskutojmë dhe nuk po bëjmë debat politik. Po bëjmë debat teknik për ligjin dhe për mirëfunksionimin e këtij ligji, për mirëfunksionimin e prokurorisë, a do të jetë i zbatueshëm ky ligj ose jo, a do të jetë prokuroria e Përgjithshme, prokurorët dhe drejtuesit e prokurorive në gjendje që ta zbatojnë mirë këtë ligj dhe të gjitha ligjet e tjera që ne kemi miratuar në funksion të reformës që kemi bërë, a do të jenë të zbatueshme këto ligje ose jo. Kaq është kjo që po themi ne. Nuk ka nevojë as të mërzhiteni, as të shqetësoheni, as të hidheni përpjetë kur ne bëjmë disa komente për ligjin

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 1?

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** - Neni 2. Përkufizime.

**Ulsi Manja** – Lidhur me nenin 2 te përkufizimet, kemi rënë dakord bashkë me ekspertët të ketë një përkufizim lidhur me juridiksionin e përgjithshëm për të bërë dallimin gjithmonë nga prokuroria e posaçme nga strukturat e SPAKU-t.

**Fatmir Xhafaj** – Po, zoti Hoxha.

**Artan Hoxha** – Ne e vlerësojmë.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 3. Objekti i veprimtarisë së prokurorisë.

**Ulsi Manja** – Jemi dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 4.

**Ulsi Manja** – Jemi dakord me nenin 4.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 5.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 6. Pavarësia e prokurorëve.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Do ta përputhni me atë që keni bërë dje? Paragrafi i 3-të me ndryshimin që u bë dje.

**Ulsi Manja** – Po.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit! Dakord me ndryshimet.

Neni 7. Mbrojtja dhe statusi i prokurorit.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Profesor, mos duhet të ndryshojmë vendet. 2-shi të shkojë te 1-shi dhe anasjelltas, sepse ka koncept më të gjerë.

Dakord.

Neni 8. Objektiviteti dhe barazia.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 9. Konfidencialiteti i të dhënave.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 10. Respektimi i rregullave të etikës dhe sjelljet profesionale.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 11. Ushtrimi i funksionit të prokurorit.

**Ulsi Manja** – Në nenin 11 kemi rënë dakord të ketë një riformulim të paragrafit të dytë për të qartësuar se çfarë presupozon delegimi. Pra të qartësojmë konceptin e delegimit të përgjithshëm me delegimin e posaçëm.

**Fatmir Xhafaj** – Zoti Hoxha.

**Artan Hoxha** – Ka një shqetësim lidhur me konceptin e delegimit të funksioneve. Pavarësisht mendimit të ndryshëm që ne kemi, për sa i përket shprehjes që nuk bëhet fjalë për delegim funksioni, por bëhet fjalë për delegim të veprimeve procedurale, ne e kemi bërë shënimin këtu, kemi pasur dyshimet tona.

Ne themi që të bëhet një riformulim i 2-shit për të hequr këtë keqkuptim që krijohet, sepse ajo që themi, marrja përsipër e funksioneve nga autoritetet e tjera në çdo rast është e ndaluar, por dhënia apo delegimi i disa funksioneve...

Pra, riformulimi, paragrafi i dytë ne...

**Fatmir Xhafaj** – Për të lejuar dhënien nga vetë prokurori...

Dakord. Një pjesë të kompetencave praktikisht ai ia delegon oficerit të Policisë Gjyqësore në ushtrimin e detyrës dhe duhet ta parashikojë...

**Artan Hoxha** – Jemi dakord me vërejtjen që është bërë për ta riformuluar.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 12.

**Ulsi Manja** - Dakord jam për nenin 12, për të cilin kolegu Muçmataj ka diçka për të thënë.

**Vexhi Muçmataj** - Në nenin 12 “Prokuroria organizohet dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor me përjashtim të prokurorisë së posaçme që rregullohet me ligj të posaçëm,” krijohet përshtypja që prokuroria e posaçme nuk organizohet pranë sistemit gjyqësor me këtë mënyrë formulimi. Mendoj se mund të rregullohet.

**Fatmir Xhafaj** - Po, mënyra si është paraqitur duket sikur njëri është pranë sistemit gjyqësor, kurse tjetri është një strukturë më vete.

Zoti Bylykbashi.

**Oerd Bylykbashi** – Duke ndarë të njëjtin shqetësim, a është e nevojshme të thuhet në mënyrë specifike, sepse rregullimin e kemi të ligji tjetër?

**Fatmir Xhafaj** – Po, zoti Hoxha.

**Artan Hoxha** – Një rregullim i menjëhershëm mund të jetë që prokuroria organizon dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor. Prokuroria e posaçme rregullohet me ligj të veçantë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

**Oerd Bylykbashi** – Problemi është që kur themi që rregullohet me ligj tjetër duket sikur po delegojmë nga ky ligj në...

**Fatmir Xhafaj** – E lëmë pranë sistemit gjyqësor.

**Artan Hoxha** – Ka një kuptim, nëse më lejoni. Organizimi i prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm është pranë çdo organizmi gjyqësor. Pra, siç është organizuar gjykata. Kurse prokuroria e posaçme nuk ndjek këtë rregull që kaluat dje.

**Fatmir Xhafaj** – Ka një përjashtim të prokuroria e shkallës...

**Artan Hoxha** – Ka rregullin që është një prokurori që mbulon të gjithë strukturën gjyqësore. Këtu është rreziku. Prandaj në themi ta ndajmë me dy fjali. E rregullojmë, sepse jepen dy koncepte njëherësh.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

**Petrit Vasili** – Ne e kemi përcaktuar kudo se çfarë është prokuroria e posaçme. E para.

E dyta, dispozita afirmative të tilla nuk thonë gjë, që të thuash se prokuroria funksionon pranë sistemit gjyqësor. Kjo nuk thotë asgjë. Ne e kemi shumë të qartë ku funksionon. Është përcaktuar në ligj jo se e dimë ne. Ky është një nen që edhe po të hiqet nuk i shton asgjë.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 13. Degët e prokurorive.

**Ulsi Manja** – Në nenin 13 ne propozojmë të hiqet, sepse është e panevojshme. Degët e gjykatave le të funksionojnë sipas atij ligji për organizmin gjyqësor, sepse ata kanë edhe juridiksion civil. Ndërsa prokuroria mund ta bëjë vetë organizmin e brendshëm të punës.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Zonja Bumçi, urdhëroni!

**Korajlka Bumçi** – *(përkthen përkthyesi)* Jam dakord. Kemi të njëjtën situatë në Kroaci dhe na ka dhënë rezultate.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

**Oerd Bylykbashi** – Besoj se ka një korrespondim shqetësimi dhe propozimi që ngre zoti Manja me shqetësimin që ngremë ne, ku edhe në gjykimin tonë mendojmë se nuk duhet të organizohet në këtë formë, sepse mund të krijojë probleme qoftë në lidhje me konflikte të kompetencave apo me shtimin e kostove. Ne gjykojmë që nuk duhet ndjekur logjika e krijimit të degëve sipas degëve të gjykatave. Me sa kuptoj unë është se korrespondojmë me zotin Manja në këtë shqetësim.

**Fatmir Xhafaj** – Zoti Manja ka edhe mbështetjen e zotit Bylykbashi, fitojnë. Unë jam kundër, por kjo nuk do të thotë se...

Zoti Muçmataj, urdhëroni!

**Vexhi Muçmataj** – Edhe unë do ta mbështes mendimin e të dy kolegëve sepse ndarja në degë e prokurorive do të krijonte probleme me kompetencën territoriale.

**Fatmir Xhafaj** – Pse? Ku e cenon kompetencën territoriale?

**Vexhi Muçmataj** - E cenon, sepse ne kemi një ndarje territoriale të caktuar sot.

**Fatmir Xhafaj** – Nuk e prek ndarjen territoriale. Në qoftë se gjykata vendos të ketë atje një degë, një seksion dhe ti ke nevojë që të caktosh një grup prokurorësh për ta forcuar, sepse ka një situatë dhe periudhë të caktuar kohe krimi, cili është problemi?

**Vexhi Muçmataj** – Unë e shikoj si problem.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, dakord. Përderisa bien edhe ata dakord, unë kam ndjekur parimin e përgjithshëm. Ranë dakord ekspertët, unë tërhiqem, sepse nuk e mbaj veten për ekspert.

Ne kemi sot 12 rrethe gjyqësore. Ky është rregulli i përgjithshëm. Në fakt nuk kemi 12. Kemi 22. Kjo do të thotë që mund të ndodhë që duke u ngushtuar me organizimin e ri t'i ngushtojmë gjykatat e shkallës së parë dhe mund të mbeten që ta kesh të nevojshme që në zona të caktuara për efekt aksesi, por edhe për efekt të situatave kriminale të caktuara ti të jesh i detyruar ta kesh këtë pa e krijuar një degë të veçantë. Është përqendrim forcash energjie dhe eficiente.

**Oerd Bylykbashi** – Zoti kryetar,

Eficienca vihet më pas sesa mundësia për konflikt kompetencash. Po ta vija koston e rritur të procedimit penal pas eficiencës do të isha dakord me ju, por më shqetëson më shumë edhe mundësia e konfliktit të kompetencave, sepse ka të bëjë me funksionimin.

**Korajlka Bumçi** – *(përkthen përkthyesi)* Degët janë për të shtuar aksesin e qytetarëve dhe më shumë ka të bëjë me anën civile.

**Vasilika Hysi** – Problemi i krijimit të degëve të gjykatave të prokurorive është rregulluar në ligjin për organizimin e gjyqësorit.

Unë dua të di nga zonja Bumçi nëse është rakorduar me pjesën e ekspertëve që kanë punuar për ligjin e organizimit gjyqësor, sepse në atë ligj nuk janë hequr degët.

Gjithashtu, te degët që janë krijuar pranë gjykatave, ato kanë jo vetëm çështje civile, por kanë edhe çështje të vogla penale. Shqetësimi im i vetëm është që nëse ne do të vendosim t'i heqim degët e prokurorisë dhe unë bie dakord me opinionin e ekspertëve që kanë studiuar mirë, duhet të jemi shumë të kujdesshëm edhe te ligji “Për organizimin e gjyqësorit”, i cili nuk ka ardhur ende për votim në komision.

**Korajlka Bumçi** – *(përkthen përkthyesi)* Kemi biseduar disa muaj më parë, ndaj nuk e di se cila është situata e rregullimit në atë ligj. në qoftë se ka edhe çështje të vogla penale ndoshta na duhet t'i lëmë edhe degët.

**Fatmir Xhafaj** – Urdhëroni!

**Artan Hoxha** – Ne jemi dakord me të dyja opinionet. Është një opinion, që nuk është e domosdoshme të jenë degët e prokurorisë, edhe në situatën që degë të gjykatave do të ekzistojnë. Po të shikojmë një dispozitë më sipër thotë që funksionon pranë sistemit gjyqësor

dhe sistemi gjyqësor organizon nivelet jo sesi ndahet vetë. Pra, ka të bëjë me juridiksionin dhe këtë juridiksion unë si prokurori e ushroj brenda juridiksionit që ka gjykata në territorin që ka me degë pa degë, me një apo me dy degë.

**Fatmir Xhafaj** – Nuk vuri njeri konfliktin juridiksional këtu. Këtu folëm për dy gjëra. Jo, jo, ju lutem, mos abuzoni me fjalën.

Folëm për dy gjëra. Folëm për eficiencën dhe aksesin, jo për konfliktin juridiksional. Nuk ka konflikt juridiksional.

**Artan Hoxha** – Ndjekja penale nuk ka pse të ndjekë organizimin...

**Fatmir Xhafaj** – Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar,

Unë pajtohem me opinionin që solli zonja Bumçi, që të kontrollojmë edhe një herë juridiksionin e degëve të gjykatave dhe ta lëmë të hapur, meqenëse të hënën fillojmë diskutimin e ligjit.

**Fatmir Xhafaj** – Zonja Bumçi, urdhëroni!

**Korajlka Bumçi** – (*përkthen përkthyesi*) Kjo ishte ideja. Do ta kontrolloj si është bërë rregullimi në atë ligj dhe ta vendosim. Të mbetet e hapur.

**Fatmir Xhafaj** – E lëmë të hapur meqenëse thotë edhe zonja Bumçi.

Zoti Rakipi, urdhëroni!

**Arben Rakipi** – Vetë dispozita është e hapur. Vetë dispozita e kushtëzon ngritjen e strukturës së degës me ngritjen e gjykatës përkatëse. Për sa kohë që gjykata nuk do të ngrihet, nuk do të ngrihet as prokuroria.

**Fatmir Xhafaj** – Po, edhe zonja Bumçi ka kërkuar kohë për këtë gjë.

**Arben Rakipi** – Edhe nëse dispozita mbetet kështu siç është nuk ka efekt për sa kohë nuk ka efekt në dispozitat bazë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Ta lëmë të hapur që ta dakordësojmë.

Neni 14. Organizimi, drejtimi i prokurorisë.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 15. Prokuroria e Përgjithshme.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Urdhëroni!

**Adnan Xholi** – Për sa u përket kompetencave të prokurorit të Përgjithshëm dhe në vijim pastaj të kompetencave të prokurorisë së posaçme nuk është parashtruar në rastet e praktikës, nëse do të kemi ndonjë çështje në konflikt kompetence lëndore midis një çështjeje të SPAK-ut dhe prokurorisë së zakonshme.

Cili institucion do ta zgjedhë? Le të përfshihet cilido drejtues, ose Këshilli i Lartë i Prokurorisë, por kjo nuk është përfshirë në asnjë nga dispozitat ligjore.

**Fatmir Xhafaj** - Është te ligji për SPAK- un. Megjithatë, mbajeni shënim, ju lutem!

**Adnan Xholi** - Mund të ketë konflikt kompetence lëndore.

**Fatmir Xhafaj** – Urdhëroni!

**Vexhi Muçmataj** – Mendoj se ka të drejtë. Kur ka konflikt kompetence, cili duhet ta zgjidhë? Cili duhet të disponojë me një vendim që kjo kompetencë të takon ty?

**Ulsi Manja** – Zoti Muçmataj, dje kemi kaluar ligjin për SPAK-un dhe kemi folur për dy nene: kompetencën parësore dhe kompetenca të tjera. Çdo veprë penale tjetër, pavarësisht se nuk është në kompetencën lëndore të SPAK-ut, do të shkojë me veprën kryesore, të gjitha veprat penale.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

**Ulsi Manja** – Është e sqaruar te ligji i SPAK-ut.

**Fatmir Xhafaj** – Mund të ketë keqinterpretime. A mund ta lini te kompetencat e Këshillit?

**Ulsi Manja** – Nëse është e nevojshme, mund ta definojmë te kompetencat e tij.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Fatmir Xhafaj** – Zoti Hoxha, e kishim si shqetësim dhe e diskutuam edhe atje. Pse e përsëriti, nuk bëri ndonjë gjë të keqe.

**Artan Hoxha** – Këto janë ligje organike, që nuk e zgjidhin mosmarrëveshjen e kompetencave. Megjithatë, e zgjidh Kodi i Procedurës Penale se ku do të përcaktohet zgjidhja e mosmarrëveshjeve, ashtu siç rregullohet për të gjitha aspektet e tjera të kompetencës dhe juridiksionit. Janë dispozitat e para të Kodit, që ne i kemi rregulluar praktikisht në projektligj për Kodin e Procedurës Penale.

Ndërkohë, në ligjin që kaluat dje ju keni bërë një përcaktim të prioritetit që ka prokuroria e posaçme në raport me prokurorinë e juridiksionit të përgjithshëm për marrjen e çështjeve.

**Fatmir Xhafaj** – Kur veprat janë të lidhura.



**Artan Hoxha** – Nuk është shqetësim për këtë moment, e kemi mbajtur shënim.

**Fatmir Xhafaj** – Moza, mbajeni në vëmendje, që kur të vijë Kodi i Procedurës Penale, të shikojmë si është reflektuar! Mendoj se është shqetësim i drejtë.

Neni 6.

**Vasilika Hysi** – Kur kemi diskutuar dje ligjin e SPAK-ut, u kemi dhënë të drejtë prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme të ndihmojnë, të veprojnë në emër të prokurorisë së posaçme për përfaqësimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë. Në paragrafin e dytë të këtij neni ne e përjashtojmë rolin e Prokurorisë së Përgjithshme, me përjashtim të çështjeve...

**Fatmir Xhafaj** – Jo, nuk i kemi dhënë kompetencë.

**Vasilika Hysi** – Po, e kemi diskutuar dje.

**Fatmir Xhafaj** – Jo, kemi thënë: “të ndihmojnë”.

**Artan Hoxha** – Ne kemi thënë që mund të asistojnë, jo të përfaqësojnë në emër të tyre, sepse biem në kundërshtim me Kushtetutën.

**Vasilika Hysi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 16, “Prokuroritë e posaçme”.

Besoj se jeni dakord.

Zoti Bylykbashi, do të vazhdojmë?

**Oerd Bylykbashi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 17, “Prokurorët pranë Gjykatave të Apelit”.

Keni gjë për të shtuar?

Neni 18, “Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë”.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 19, “Numri i përgjithshëm i prokurorëve”.

**Oerd Bylykbashi** – Kemi një shqetësim, që në gjykimin tonë duhet përcaktuar një numër minimal i prokurorëve, e njëjta gjë që ndoqëm me prokurorinë e posaçme. Të jetë një numër minimal prej 10 prokurorësh.

**Fatmir Xhafaj** – Republika ka 400 prokurorë. Ne do të na qeshin.

**Oerd Bylykbashi** – Ne gjykojmë se duhet të ketë një numër minimal për këtë.

**Fatmir Xhafaj** – Keni gjë për të shtuar?

**Artan Hoxha** – Vërejtja e bërë, që për prokurorinë e posaçme të përsëritet ajo që thotë Kushtetuta, nuk e bëmë dje kur kaluam ligjin. Pra, që numri minimal është dhjetë, sepse e ka thënë vetë Kushtetuta.

**Fatmir Xhafaj** – Po.

**Artan Hoxha** - Nuk është e nevojshme, e thotë neni 148. Do të ishte thjesht përsëritje.

**Fatmir Xhafaj** – Keni gjë tjetër për të shtuar? Nuk keni.

Neni 20.

**Ulsi Manja** – Dakord.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

**Fatmir Xhafaj** – Po.

**Artan Hoxha** - Në nenin 19 nuk është parashikuar se kujt do t'i propozojë prokurori i Përgjithshëm për numrin e përgjithshëm të prokurorëve. Mbase është ndonjë lapsus. Mendoj se duhet të shtohet “Këshilli i Lartë i Prokurorisë”.

**Fatmir Xhafaj** – Ka dy gjëra: numrin e përgjithshëm të prokurorëve e miraton Kuvendi.

**Artan Hoxha** – Si rregull, ku do të pasqyrohet?

**Fatmir Xhafaj** – Kuvendi, e para.

**Artan Hoxha** – Ndoshta duhet të shënohet.

**Fatmir Xhafaj** – E dyta, është marrë mendimi i këshillit, ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave, por duhet specifikuar Kuvendi. Kuvendi duhet të specifikohet bashkë me buxhetin.

**Vasilika Hysi** – Te ligji i SPAK-ut ka një riformulim shumë të mirë, ku thuhet se prokurori i Prokurorisë së Posaçme së bashku me buxhetin, propozon edhe numrin e përgjithshëm, sepse ai mund të ketë nevojë për shtesë.

**Fatmir Xhafaj** – I propozon Kuvendit.

**Vasilika Hysi** – Po, i propozon Kuvendit në bazë të ligjit...

**Adnan Xholi** – Edhe këtu mendoj se duhet shtuar “Kuvendi”.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 20, “Numri i prokurorëve për çdo prokurori”.

E lexova tek shkresat e opozitës dhe bie dakord. Muaji qershor është shumë larg, sepse ai do të raportojë në Kuvend, do të raportojë në Këshill.

**Vasilika Hysi** – Brenda muajit mars.

**Fatmir Xhafaj** – Është shumë kohë deri në muajin qershor, të paktën në mars. Në prill dhe maj shkon të raportojë. Si do të raportojë?

**Adnan Xholi** – Nëse mundet, sepse brenda muajit mars raportojnë prokuroritë e rretheve deri te prokurori i Përgjithshëm.

**Fatmir Xhafaj** – Si thatë?

**Adnan Xholi** - Brenda muajit mars bëhet raportimi i prokurorive të rretheve te prokurori i Përgjithshëm.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

**Adnan Xholi** – Duhet t’u lini pak kohë, që të përgatitet raporti.

**Fatmir Xhafaj** – Ju e keni në janar, akoma më keq.

*(Diskutime pa mikrofon).*

Unë e kam shënuar.

Zonja Hysi, urdhëroni!

**Vasilika Hysi** – Unë pajtohem me sugjerimin tuaj, sepse në vazhdim të fjalisë të paragrafit të parë ju keni thënë që bën rekomandimet për rritjen e efektivitetit të vitit. Në rast se e shtyni deri në muajin qershor, ngelet që rekomandimet t’i zbatojë vetëm për periudhën korrik-gusht e në vazhdim.

Gjithashtu, unë do të doja t’i jepej zgjidhje një problemi që ka dalë në praktik. Deri më sot, prokurori i Përgjithshëm nuk e ka botuar raportin vjetor nëse nuk është shqyrtuar në parlament. Mendoj se raporti vjetor për gjendjen e kriminalitetit nuk duhet kondicionuar me...

**Fatmir Xhafaj** – Zonja Hysi, ju lutem, kur të vemi te neni që flet për raportin e prokurorit të Përgjithshëm.

Zoti Hoxha, keni koment?

**Artan Hoxha** – Meqenëse në një dispozitë tjetër është thënë se raportimi i prokurorive për veprimtarinë dhe ngarkesën është deri në mars, muaji qershor është për të bërë përcaktimin. Të lihet një kohë. Ky është më tepër propozim i prokurorisë sesa yni.

**Fatmir Xhafaj** – Jam dakord, por ata nisen nga një praktikë, që është deri sot. Ndërkohë, ai që do të vijë të raportojë, çfarë do të raportojë?

**Artan Hoxha** – Dakord, por edhe raportimi kështu spostohet në vit.

**Fatmir Xhafaj** – Do ta spostoni dhe raportimin?

**Artan Hoxha** – Është i gjithi i spostuar.

**Fatmir Xhafaj** – Vete shumë. Po e çuat në qershor këtë, shkon në shtator raportimi.

**Artan Hoxha** – Është qershor me qershor, nuk është janar me janar, apo mars me mars. Mjafton që mbulon një volum.

**Fatmir Xhafaj** – Ideja është që deri në mars ai e mbyll. Në qershor vjen dhe raporton te ne, vjen buxheti i ri dhe e pasqyron këtë gjë, prandaj kanë lindur probleme në praktikë.

**Artan Hoxha** – Mund të bëj një koment të vogël?

**Fatmir Xhafaj** – Po.

**Artan Hoxha** – Ne sot në Shqipëri kemi një problem shumë të madh me raportimet dhe me interpretimin e statistikave, pothuajse nuk e bëjmë fare ose e bëjmë në mënyrë shumë ...

**Fatmir Xhafaj** – Jam shumë dakord me ju. Shërbimi statistikor në sistem është skandaloz.

**Artan Hoxha** - Nëse ne nuk do t’u jepnim kohë... Edhe sot që kanë kohë, nuk po e realizojnë dot si funksion, jo më t’ia heqim si kohë.

**Fatmir Xhafaj** – Jo, nuk po them gjë. Thjesht ta përputhim ...

**Artan Hoxha** – Çdo gjë është spostim në kohë. Nëse do ta bëjmë më parë, në shkurt raportimet dhe këto të bëhen në maj...

**Fatmir Xhafaj** – Shikojeni dhe na thoni!

**Artan Hoxha** – Atëherë, do ta spostojmë të gjithë skemën, jo vetëm në këtë dispozitë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Shikojeni!

**Artan Hoxha** – E shikojmë si spostim tërësor këtë pjesë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Tjetra, për atë që tha zoti Xholi, e mbështes edhe unë. Këshilli i Prokurorisë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Jo, Këshilli i Prokurorisë. Kam punuar mbrëmë natën.

Ka mundësi të vihet në dijeni Këshilli për ngarkesën e punës së prokurorëve e të tjera, sepse është organi drejtues. E bën ai, por duhet raportuar edhe Këshilli.

Neni 21, “Struktura e prokurorive”.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 22, “Seksionet e prokurorive”.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 23, “Kushtet ligjore për emërimin e prokurorit të Përgjithshëm”.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Urdhëroni, zoti Bylykbashi!

**Oerd Bylykbashi** – Ka një vërejtje nga ana jonë. Do të doja të dija mendimin e ekspertëve për kushtin e vendosur te pika 1, germa “dh”.

**Fatmir Xhafaj** – Po. “Të mos jetë bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve...”

**Oerd Bylykbashi** – Jo, germa “dh”, e fundit.

**Artan Hoxha** – Për komentin e referimit te germa “dh”, duhet saktësuar më mirë. Ne themi se neni 148 germa “d” janë rastet kur prokurori mban përgjegjësi sipas ligjit: shkarkohet kur kryhen shkelje të rënda profesionale, kur është dënuar e të tjera. Domethënë, i ka thënë Kushtetuta në mënyrë ezauruese. Nëse do t’i vendosim të gjitha këto, do të bëjmë thjesht një referencë në Kushtetutë dhe me këtë evitohet edhe ndonjë gabim.

Mendoj se shqetësimi është brenda në dispozitën kushtetuese dhe nuk është nevoja të rendisim elementet që ka vetë dispozita kushtetuese. Në diskutimin tonë, në fund të germës “c”, ku flitet për denoncuesin apo dëshmitarin e akuzës në procese politike të posaçme, vumë një shënim për të parë si është ligji i posaçëm, që të mos bëjmë gabime dhe të vëmë njerëz në vështirësi, ndërkohë ligji i posaçëm mund të mos e ketë. Kështu që do të bëjmë një verifikim të atij për të parë nëse kemi terminologji të saktë apo jo. Do t’i referohemi automatikisht ligjit të posaçëm të bashkëpunëtorëve me Sigurimin e Shtetit.

**Fatmir Xhafaj** – Aktualisht?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Artan Hoxha** – I referohemi periudhës që ka ligji i posaçëm. Për efekt të terminologjisë, duhet ta rregullojmë, që të mos kemi keqkuptime.

**Fatmir Xhafaj** – E hapur është kjo.

**Artan Hoxha** – Për shembull, është dëshmitar i akuzës. Çfarë do të thotë “dëshmitar i akuzës”? Me ligj, nëse ke pasur dijeni për një vepër...

**Fatmir Xhafaj** – Qartë.

**Artan Hoxha** – Del dëshmitar, në fund të fundit. E ke detyrim ligjor.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me nenin 23.

Neni 24, “Kriteret për vlerësimin e kandidatëve”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Te neni 23.

**Keltis Kruja** – Nuk e kuptoj germën “d”.

**Fatmir Xhafaj** – “Të mos jetë bashkëpunëtor, informator ose agjent i Shërbimit Sekret”.

**Artan Hoxha** – Do të bëj një koment. Është fjala për prokurorin e Përgjithshëm. Si mund të jetë prokurori i Përgjithshëm agjent i Shërbimeve Sekrete? Agjent do të thotë se është në marrëdhënie pune.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Pikërisht, nuk duhet të jetë i tillë. Mund të jetë i fshehtë, mund të jesh ligjrisht. Është konflikt.

**Adnan Xholi** – Mund të ndodhë të jetë agjent në mbulim, agjent i fshehtë, ndaj është parashikuar në ligj, që nuk duhet të jetë i tillë.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 24, “Kriteret për vlerësimin e kandidatëve”.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Neni 25, “Kriteret profesionale për renditjen e kandidatëve”.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 26, “Kriteret morale për renditjen e kandidatëve”.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 27.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Vexhi Muçmataj** – Kam një sugjerim te neni 27, germa “d”, “Aftësive të provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi” dhe më pas vazhdon “dhe vendime bazuar edhe në përvoja të mëparshme”. Mendoni se duhet rregulluar?

**Fatmir Xhafaj** – Lidhëzat “dhe” dhe “dhe”.

**Vexhi Muçmataj** – Thotë “vendime” dhe më pas “dhe vendime”.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Ka nevojë për një teknikë, ka të drejtë. Zoti Muçmataj, vërejtje me vend, si përherë.

Neni 27, dakord me vërejtjen e bërë.

Neni 28.

**Ulsi Manja** – Dakord me nenin 28.

**Oerd Bylykbashi** – Te neni 28 kemi një shqetësim. Ne gjykojmë se kriteret e paraqitura këtu krijojnë një ngushtim dhe mund të flitet edhe për emra.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Ulsi, dëgjoje!

E para, të them të drejtën, kandidatët që janë kryesisht të fokusuar te bota akademike, sepse të shkosh në këto drejtime, përveç asaj që mund të jetë dikush, që e ka marrë thjesht për formë titullin akademik, ne e ngushtojmë dhe e çojmë drejt botës akademike dhe jo aspektit praktik. Prokuroria është më shumë me prakticitetin e gjësë. Sigurisht, titujt shërbejnë, por nuk mund të jenë parësorë.

Ne gjykojmë se kështu, siç janë parashikuar, janë ngushtuese, çojnë në drejtim jo...

**Fatmir Xhafaj** – Si mund të bëhet?

**Oerd Bylykbashi** – Ne po ngremë shqetësimin.

**Fatmir Xhafaj** – Si mund të bëhet, që edhe të mos i injorosh?

**Oerd Bylykbashi** – E para, ekziston shqetësimi, apo jo?

E dyta, ju thoni “njohja e gjuhëve të huaja”. Çfarë problemi kam unë në qoftë se prokurori i Përgjithshëm nuk ka gjuhë të huaja?

**Fatmir Xhafaj** – Nuk është kushtëzuese, thuhet se është plus.

**Oerd Bylykbashi** – Duhet ta vënë patjetër këtë në ligj? Pse? Sepse prokurori i Përgjithshëm nuk merret vesh me ekspertët e huaj? Çfarë problemi kam unë këtu? Po diskutojmë kot.

**Fatmir Xhafaj** – Zonja Bumçi, urdhëroni!

*(Flet anglisht.)*

**Vasilika Hysi** – Shqetësimi që ngre zoti Bylykbashi është i zgjidhur, sepse nenet 23, 24, 25, 26 dhe 27 flasin për kushtet dhe kriteret bazë. Në nenin 23 janë shtesa të detajuara. Nëse do të riformulohen kriteret bazë dhe gjithçka që lidhet me shkollimin, profesionalizmin, renditjen morale, vlerësimin e kandidatëve, do të sugjeroja të rregullojmë edhe terminologjinë. Nuk mund të themi “zotëron grada”. Ka përdorim teknologjie në ligjin për arsimin e lartë për titujt dhe gradat shkencore.

**Fatmir Xhafaj** – Bëni një formulim të përmbledhur!

**Keltis Kruja** – Siç është e formuluar, nuk shikohen si kritere shtesë, sepse thuhet: “Në vlerësimin e kandidatëve do të merren në konsideratë...”. pra, krahas.

*(Ndërhyrje p mikrofon).*

Dakord, po kush e ndan se cili do të prevalojë?

**Fatmir Xhafaj** – E ndan vetë këshilli në vlerësim.

**Keltis Kruja** - Ky është problemi, kështu që të mos e ...

**Fatmir Xhafaj** – Nuk është kusht.

**Keltis Kruja** - Sigurisht që nuk është kusht, por mund të kthehet në kusht, sepse thotë “do të merret në konsideratë”.

Këtu mund të ngatërrohet vlerësimi, edhe këshilli mund ta ngatërrojë. Përderisa po e diskutojmë deri në detaje ligjin, pse duhet të lëmë të tilla gepe ligjore që mund të krijojnë situata të pakëndshme?

**Fatmir Xhafaj** – Bëni një riformulim që të japë idenë e kritereve shtesë, preferencial.

**Oerd Bylykbashi** – Është ajo që thotë zoti Kruja, se për sa kohë që është kriter ligjor, fakti që është shtesë, dhe një grup ndoshta i ngushtë e ka, i vë ata në një korsi preferenciale shumë të qartë. Mund të kenë eksperiencë, por kanë atë titull. Mund të jetë një prokuror me eksperiencë të jashtëzakonshme, por nuk di gjuhë të huaja, kemi edhe dikë tjetër që plotëson më shumë në *check-listën* e kritereve, përfshirë edhe kriteret preferencialet dhe kjo e ngushton në atë drejtim. Është gjë tjetër kur në një aplikim themi: “kritere të preferueshme do të ishin edhe këto”, por nuk është e njëjta gjë, sepse kjo është e shkruar në ligj dhe për rrjedhojë, po e pata unë, jam i preferuar karshi të gjithë kandidatëve të tjerë.

**Fatmir Xhafaj** – Nuk mund ta nxjerrë ai jashtë ligjit, prandaj do ta vendosësh këtu, që ai kur të vendosë shpalljen...

**Oerd Bylykbashi** – Të vendosë kritere të mira bazë.

**Fatmir Xhafaj** – Kriteret bazë janë te neni 27.

**Oerd Bylykbashi** – Megjithëse ideja për ta bërë statisticien, ndoshta na duhet të vëmë edhe një herë statistikën.

**Fatmir Xhafaj** – Zoti Hoxha, ju lutem!

**Artan Hoxha** – Ideja këtu ka të bëjë me vlerësimin e kandidatit. Një kandidat që ka më shumë aftësi të tjera, vlerësohet, por kjo nuk prevalon ose e bën një kandidat më të mirë sesa një kandidat që nuk i ka këto. Ne mund të thoshim se në vlerësimin e kandidatëve, veç kritereve të përcaktuara në nenet përkatëse, mund të merren në konsideratë edhe shtesat. Në këtë pikëpamje nuk i konsiderojmë si kritere, por si vlerësim, i cili ka kuptim. Ta rregullojmë.



**Fatmir Xhafaj** – Dakord, “mund të merren”.

**Artan Hoxha** – “Mund të merren në konsideratë”. Të mos i quajmë kritere, por elemente vlerësuese.

**Fatmir Xhafaj** – Mund të merret këshilli, është subjektiv.

**Artan Hoxha** – Themi “vlerësime të tjera”. Për nenin 28 nuk është ideja t’u japim prevalencë këtyre, por thjesht elemente vlerësimi.

**Fatmir Xhafaj** – Për riformulimin thamë që ta lëmë në çmimin e këshillit.

**Keltis Kruja** – Te neni 24, duke qenë se ne kemi përcaktuar kriteret dhe kriteret janë kritere në bazë të ligjit, nuk mund të kemi dy lloje kriteresh, disa që janë bazë dhe disa të tjera që mund të merren shtesë. Një riformulim i kësaj mendoj se do të ishte i nevojshëm, që të mos ketë keqkuptime. Kriteret janë këto. Sigurisht, mund të ketë më pas edhe..

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

U mirëkuptuam për nenin 28.

Neni 29, “Organi përgjegjës për përzgjedhjen.

Keni gjë për këtë nen? Nuk keni.

Dakord.

Neni 30.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Vasilika Hysi** – Kam diçka për nenin 30.

**Fatmir Xhafaj** – Urdhëroni!

**Vasilika Hysi** – Në pikën 2 të nenit 30 ju flisni për shpalljen zyrtare në Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe thoni “si dhe një gazetë me shpërndarje kombëtare dhe tirazh të mjaftueshëm, ose në radiotelevizion”. Ne kemi kaluar një ligj për njoftimet publike dhe është mirë të respektojmë kërkesat e ligjit për Qendrën e Publikimeve Zyrtare, ku thuhet si të bëhen njoftimet zyrtare.

Nga ana tjetër, duhet të kemi kujdes që ligji i prokurimeve publike përcakton disa rregulla për tirazhet e tjera. Është hera e parë që ne shikojmë një terminologji të tillë në ligj dhe duhet unifikuar me terminologjinë që kemi përdorur te ligji për qeverisjen, aty ku bëhet njoftimi dhe shpallja e vendeve për magjistratët, për kandidatët e të tjera. Vetëm kjo terminologji të rregullohet!

**Fatmir Xhafaj** – Besoj se do ta merrni në konsideratë sugjerimin e zonjës Hysi.

*(Mungesë incizimi.)*

**Artan Hoxha** ...një reflektim të njëhershëm te kjo është të mos thuhet “ose në radiotelevizionin publik”, por të thuhet “dhe radiotelevizionit”. Pra, të bëhet e detyrueshme.

Më pas të shikojmë nëse ka ndonjë gjë tjetër.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit për mirëkuptimin!

Neni 31, “Paraqitja e shprehjes së interesit”.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Oerd Bylykbashi** – Kam një vërejtje.

**Vasilika Hysi** – Unë ka një sugjerim për afatin.

Në të gjitha ligjet që ne po kalojmë paketë, u kemi dhënë mundësi kandidatëve të paktën 30 ditë, sepse ata do të paraqesin një platformë, një vizion, do të bëjnë dokumente, do të mbledhin dokumente. Vetëm procedura për mbledhjen dhe për të ideuar dokumente në institucione nuk është e mjaftueshme për 15 ditë.

**Fatmir Xhafaj** – Ai e ka menduar më parë, Vasilika.

**Oerd Bylykbashi** - E shikoj që zonja Hysi është bindur nga vërejtjet që kemi ngritur ne.

**Fatmir Xhafaj** – Edhe juve nuk ju mjafton 15-ditëshi?

Meqenëse do të përgjigjeni për këtë, më thoni: a mundeni që te germat “c” dhe “ç” të thoni një deklaratë sipas kushteve të nenit kaq... Ju i filloni edhe një herë: një deklaratë që nuk ka qenë kandidat i Byrosë Politike, bashkëpunëtor, informator ose agjent i Shërbimit Sekret, sipas kushteve të atij neni dhe kaq.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po, sepse mbushet ligji me paragrafë parazitare.

**Artan Hoxha** – Germat “c” dhe “ç” mund t’i rregullojmë. Këto do t’i keni parasysh kur të vijë edhe ligji për qeverisjen, sepse kemi mbajtur një strukturë.

**Fatmir Xhafaj** – Po.

**Artan Hoxha** – Për sa u përket 15-ditëve, edhe nga zoti Bylykbashi është paraqitur afati, por ne themi se këtu nuk bëhet fjalë që këtyre do t’u duhet 15-ditëshi kohor për të paraqitur platformën. Ai që mendon se duhet të jetë prokuror i Përgjithshëm e ka menduar më parë.

**Fatmir Xhafaj** – E ka menduar një vit më parë.

**Artan Hoxha** – E dyta, ne kemi vënë një afat 15-ditor, sepse, po e lamë 20 ditë ose 1 muaj, bëhet si çështje volumpariste. Unë e kam shkruar “sa të doni”, sepse është vlerësimi juaj,

por procesi humbet në kohë vetë, sepse ka edhe disa faza të tjera. Kjo nuk është gjë parimore, thjesht e mban procesin që të mos zgjatet në kohë. Afati mund të jetë edhe 20 ditë ose 1 muaj, por do të zgjatet koha, nuk është parimore. Ai që do të jetë prokuror i Përgjithshëm nuk e mendon 15 ditë nga shpallja, e ka menduar kohë më parë.

**Keltis Kruja** – Sigurisht, është ajo që thoni ju, se normalisht duhet ta ketë menduar më parë, por edhe një kandidat për prokuror të Përgjithshëm, në qoftë se nuk i paraqet dokumentet brenda 15-ditëve dhe ne t'i heqim të drejtën të kandidojë për prokuror të Përgjithshëm, më duket pak anormale. Besoj se nuk shtyhet shumë kohë edhe nëse e bëjmë 30 ditë, duke pasur parasysh se do të mbledhë të gjitha dokumentacionet që ne kemi referuar në draft.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Ndoshta 30 ditë janë shumë, dakord. Të mos e bëjmë lojë kungulleshkash.

**Oerd Bylykbashi** – Duke e mbështetur atë që tha Kelti pak më parë, ne mund të riskojmë përtej asaj që imagjinojmë, kush e ka ndarë mendjen për kandidaturën e prokurorit të Përgjithshëm do të përgatitet një vit më parë, e thamë në mënyrë informale këtu. Kjo është logjika, por mund të mos jetë kështu. Mundet që kandidatë të mirë të dalin në momentin e fundit, vendosin dhe angazhohen dhe afati 15-ditor mund të mos jetë i mjaftueshëm për të përmbyllur kërkesat dokumentare.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Më pas është fat i keq. Unë mund t'i lë 30 ditë dhe ai e ndan mendjen në datën 29. Pyetja që shtrohet këtu është: meqë shqetësimi i zotit Hoxha për zgjatjen e procesit, duke qenë se ne e nisim 4 muaj para fundit të mandatit, zgjatja me një muaj, (momenti i kandidimit është shumë i rëndësishëm), a na prish punë që ne ta përfundojmë të gjithë procesin me afatet e tjera para mbarimit të mandatit? Nëse mbaron më parë, unë mendoj ta zgjasim. Pse? Po parashikojmë të drejtën për të kandiduar për një funksion publik në qeverisjen e vendit, e drejtë themelore e parashikuar nga Deklarata Universale e Kombeve të Bashkuara, dokumenti i Kopenhagenit, dokumente që më lejojnë mua të konkurroj në vendin tim i lirë, i papenguar. Nëse është kjo dhe prokurori i Përgjithshëm është i rëndësishëm, është shumë i rëndësishëm edhe momenti i kandidimit, ku përfshihet edhe dokumentacioni. Nëse kemi afate që e përmbyllin të gjithë procesin, nëse e zgjasim...

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Të mos zihemi për afatin, vendoseni si të doni.

**Oerd Bylykbashi** – Gjykojeni kështu.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

*(Mungesë incizimi.)*

**Artan Hoxha** – Është një vërejtje për terminologjinë që përdoret: “Byroja Kombëtare e Hetimit” versus “njësia e posaçme hetimore sipas Kushtetutës”.

Këtë e diskutuat edhe dje dhe e kaluat në ligjin për SPAK-un. Unë them se ka një argument, që Kushtetuta nuk i vë emrin njësisë së posaçme hetimore, por thotë “ndërtohet njësia e posaçme hetimore si një strukturë pranë hetimit”. Se si ia vë emrin kësaj strukture, është marrëveshje fjale, ajo që kemi përdorur në ligjin për SPAK-un. Edhe kësaj strukture ia kemi vënë emrin “Byroja Kombëtare e Hetimeve”.

Funksioni ka më tepër rëndësi sesa emri. Ne nuk mendojmë se ka problem me Kushtetutën, një diskutim që e bëtë edhe dje.

**Oerd Bylykbashi** – Këtu, në mos gaboj, duhet verifikuar. Kam përshtypjen se për shkak të riformulimit gjenerik të terminologjisë për Shërbimin Informativ Shtetëror në Kushtetutën e 98-ës u ndryshua dhe emërtimi i Shërbimit Informativ Kombëtar dhe u përshtat me formulim kushtetues. Shërbimi Informativ Shtetëror është term absolutisht i përgjithshëm, nuk thotë asnjë gjë.

Ndërkohë, u konsiderua në atë kohë. Në mos gaboj, kjo çështje ka një vendim të Gjykatës Kushtetuese ose është investuar para Gjykatës Kushtetuese diku nga fillimi i viteve 2000.

Ne gjykojmë se është mirë që kjo të jetë, sepse për më tepër...

**Fatmir Xhafaj** – Nuk është gabimi se ka dy-tre të kësaj natyre. Te përkufizimet sqarojeni: “Njësia e posaçme hetimore....

**Oerd Bylykbashi** – Sa po e thosha këtë, por kjo duhet edhe te ligji tjetër.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Ramë dakord të vendosim për ta saktësuar te përkufizimet. As nuk shton, as nuk pakëson, kështu që nuk prish punë, vetëm rregullon.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Neni 33, “Renditja e kandidatëve”.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 34.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Oerd Bylykbashi** – Kam një vërejtje, që është pika 10 e vërejtjeve për renditjen: “Renditja e kandidatëve duhet të bëhet nga KLP pas procedurës së ankimit të përcaktuar në nenin 32, pika 7”.

**Fatmir Xhafaj** – Si?

**Oerd Bylykbashi** – Duhet të përcaktohet. Renditja e kandidatëve duhet të bëhet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë pas procedurës së ankimit të përcaktuar në nenin 32, pika 7.

**Fatmir Xhafaj** – E thotë: “Pas shpalljes së vendimit për lejimin e kandidimit”. Është shumë e qartë në pikën 6, nuk ka 7 pika. Pse duhet t’i referohesh dispozitës?

Neni vijues thotë: “Pas lejimit të gjykatës”.

Neni 34, “Seanca dëgjimore”.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 35.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Artan Hoxha** – Për nenin 34, kemi përcaktuar se pas renditjes bëhet intervista e kandidatëve. Propozimi është që renditja të bëhet pas intervistës. Kjo është diferenca midis asaj që është paraqitur në projekt me atë që propozohet nga zoti Bylykbashi.

**Fatmir Xhafaj** – Bën sens, në fakt.

**Artan Hoxha** – Për ne nuk ka asnjë problem. e vetmja gjë që ne kemi...

**Fatmir Xhafaj** – E di pse? Sepse ti duhet ta dëgjosh, pastaj ta rendisësh, sepse renditja ka edhe një element subjektiv të keshillit.

**Artan Hoxha** – Ne kemi thënë që të intervistohen gjashtë të parët, sepse një del.

**Fatmir Xhafaj** – Çfarë problemi keni ju nëse studiohen të gjithë?

**Artan Hoxha** – Sepse mund të jenë 20 ose 30, ne nuk e dimë.

**Fatmir Xhafaj** – Jo, nuk mund të jenë 20 ose 30 kandidatë për prokuror të Përgjithshëm.

**Artan Hoxha** – Edhe vendet e tjera, ku kemi marrë shembullin, kështu e kanë. Lënë një numër, një kufi.

**Fatmir Xhafaj** – Le t’i dëgjojë keshilli nga 5 minuta 20 ose 30 kandidatët, sepse nuk ka asnjë gjë të keqe.

**Artan Hoxha** – Domethënë, për ne të dyja variantet janë në rregull. Nëse do të pranojmë këtë...

**Fatmir Xhafaj** – Të mos e përjashtojmë këtë, sepse do të thonë: mua më përjashtuan, atë nuk e përjashtuan, po të më kishin dëgjuar mua, do të kishin qarë ata, do të ishin prekur shpirtërisht.

**Artan Hoxha** – Në qoftë se ju bini dakord, e ndryshojmë renditjen.

**Fatmir Xhafaj** – Ndryshojeni!

**Artan Hoxha** – Atëherë, pranohet vërejtja e bërë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Jeni dakord për nenin 35?

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Oerd Bylykbashi** – Kemi një vërejtje për nenin 35.

**Fatmir Xhafaj** – Ka një sugjerim për të kontrolluar themelin e vlerësimit në gjykatë.

Unë jam pak më në ekstrem. Pse duhet të shkojë të ankohet në gjykatë për mënyrën se si vendos këshilli?

**Oerd Bylykbashi** – Atëherë, që të kuptohemi. E drejta për të marrë një funksion publik në qeverisjen e vendit ku je shtetas, është e drejtë themelore dhe si e tillë, ekzistojnë dy forma: me zgjedhje ose me emërim. Për sa kohë që është me zgjedhje dhe me konkurrim, unë kam të drejtën që, kur i përputh kushtet, t'i drejtohem. Ama, duhet të kem të drejtën për t'u ankuar edhe përpara një gjykate nëse unë i kisha kriteret, por përjashtimi ishte i padrejtë. Kjo nuk bën diferencë, sepse në fund ka një zgjedhje. Kjo nuk bën diferencë as nga mënyra se si dikush i drejtohet kandidimit për t'u zgjedhur me zgjedhje të drejtpërdrejtë. Pra, ose me zgjedhje të drejtpërdrejtë, ose zgjedhje indirekte. Unë mendoj se kriteret i kap, një organ administrativ gjykon se unë nuk i përmbush dhe për rrjedhojë më skualifikon. E drejta ime për ta gjetur këtë përpara një gjykate është një e drejtë që nuk mund të hiqet, sepse është një konkurrim i hapur, i lirë për të marrë një funksion publik.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po, të njëjtën gjë që bëjmë sot kur kandidojmë për t'u zgjedhur qoftë për deputet dhe KQZ-ja thotë: nuk i ke kushtet.

**Fatmir Xhafaj** – Nuk ka vlerësim në meritë kur zgjidhesh deputet, Oerd.

**Oerd Bylykbashi** – Merita është për aq kritere sa përcakton Kushtetuta.

**Fatmir Xhafaj** – Për deputet, të votojnë zgjedhësit dhe mbaron.

**Oerd Bylykbashi** – Jo, ky është koncept bazë. E drejta ime për kandidim kap kushtet. Nëse dikush shkel të drejtën time, unë ankoem para një gjykate.

**Fatmir Xhafaj** – Këtu nuk biem dakord.

**Oerd Bylykbashi** – Kjo mund të ketë probleme nesër, mund të hapë probleme të karakterit kushtetues.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

**Ulsi Manja** – Për nenin 35 biem dakord, siç e ka drafti.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Nuk më vjen keq, keni mendimin tuaj.

**Artan Hoxha** – Këtu nuk bëhet fjalë për përjashtimin e atij që nuk ka kriteret, por për renditjen. Lihet një ankim formal në gjykatë, por gjykatës nuk mund t'i japësh themelin e vlerësimit të kriterëve, sepse po ia dhe, ke shkelur Kushtetutën. Kushtetuta thotë se kandidati i renditur i pari nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë shpallet i emëruar. Në përmbajtje, është Këshilli i Lartë i Prokurorisë ai që e përcakton. Në të kundërt, i mbetet gjykatës. Nëse gjykata ka një gjykim të ndryshëm nga Këshilli i Lartë i prokurorisë për përmbajtjen, për themelin, atëherë ikën kjo kompetencë, nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, shkon në gjykatë.

Ndërkohë, verifikimi i gjykatës është për përjashtimin, nëse është përjashtuar gabimisht, dhe për elemente të tjera që kanë të bëjnë me formalitetin e renditjes. Por jo në fund të ditës të jetë i ndryshëm nga ai që ka Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Përndryshe, ajo spostohet, bëhet si kthimi i pronës më vendim gjykate dhe jo nga Komisioni i Kthimit të Pronave.

**Fatmir Xhafaj** – Ky ishte shpjegimi edhe nga pikëpamja kushtetuese, kështu që edhe zoti Bylykbashi është i qartë besoj.

Dakord për nenin 35.

Neni 36, “Emërimi i prokurorit të Përgjithshëm”.

**Ulsi Manja** - Dakord.

**Artan Hoxha** – Deri te neni 43 nuk ka vërejtje.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 37.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 38.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Te neni 36 është pjesa që rregullon... Pjesën e Kuvendit e ka Rregullorja, kështu që ne do të ecim me logjikën e Rregullores.

**Ulsi Manja** – Jo, me logjikën e Rregullores së Kuvendit për mënyrën e zgjedhjes.

**Fatmir Xhafaj** – Edhe Kushtetuta është e qartë.

Neni 37, dakord.

Neni 38, dakord.

Neni 39, dakord.

Neni 40, dakord.

**Vasilika Hysi** – Në pikën 5 të nenit 40 në fund të fjalisë do të themi: “Të përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni”.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Zoti Xholi, urdhëroni!

**Adnan Xholi** – Te pika 4 e nenit 40: “Zëvendësprokurori i Përgjithshëm emërohet nga prokurori i Përgjithshëm me një mandat 2-vjeçar me të drejtë riemërimi, pasi ka marrë mendimin e mbledhjes së prokurorëve të prokurorisë”.

Të cilës prokurori? Të të gjitha prokurorive, apo të prokurorisë...?

Mendimi i prokurorëve të prokurorisë përkatëse.

Të cilës prokurori? Duhet të thotë: prokurorë të Prokurorisë së Përgjithshme apo prokurorë të...

**Fatmir Xhafaj** – Më fal, nëse...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Fatmir Xhafaj** – Brenda Këshillit të Prokurorisë. Tani, logjikisht ai është për të gjithë prokurorët, sepse është zëvendës për të gjithë prokurorinë e republikës.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

E keni gabim. Më vendos mua prokuror të Përgjithshëm, sepse do të ..

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Është më mirë ajo e këshillit.

E prokurorisë përkatëse, sepse ai është zëvendësprokuror i Përgjithshëm, nuk është zëvendës i një prokurorie.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Nuk diskutohet, por mendimi i kujt duhet të merret?



Ai është prokuror i gjithë Shqipërisë, që në mungesë të prokurorit të Përgjithshëm drejton të gjithë institucionin. Është një figurë e rëndësishme, mos e bëni...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Është gjithë ai insion që administrohet dhe drejtohet. Çfarë po thoni?! Ai ikën kur ikën ai.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Ka krijuar probleme në praktikë mospasja e një zëvendësprokurori të Përgjithshëm.

Saktësojeni këtë, zoti Rakipi, që të jetë “prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme ose Këshillit të Prokurorisë”.

Neni 41, “Buxheti”.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Vasilika Hysi** – Kryetar, te fjalia e parë: “Prokurori ka buxhet të pavarur që përballohet...”. Jo, “Prokuroria ka buxhet të pavarur si pjesë e buxhetit të shtetit dhe parashikohet në një kapitull të veçantë të tij”.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me sugjerimin.

Keni gjë tjetër?

Neni 42, “Drejtimi në prokurori”.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Vasilika Hysi** - Mund të bëj një vërejtje të përgjithshme për kapitullin?

**Fatmir Xhafaj** – Po.

**Vasilika Hysi** – Unë shikoj se në disa nene të kapitullit flitet në njëjës “drejtuesi” dhe në disa nene të tjera flitet në shumës “drejtuesit”. Ose duhet të themi në njëjës dhe të përcaktojmë kompetenca, ose do t’i themi të gjithë në shumës, atje ku ka më shumë se një, sepse shikoj se ju thoni “kompetencat e drejtuesve” dhe më pas “përgjegjësitë e drejtuesit ose të zëvendësprokurorit”. Ky është një rregull i teknikës legislative, nuk ka lidhje me përmbajtjen, vetëm me standardin.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 43.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Oerd Bylykbashi** – Te neni 43 ka një sugjerim nga ana jonë për dy momente: raportimi i drejtuesve të prokurorisë te prokurori i Përgjithshëm bëhet për gjendjen e kriminalitetit në juridiksionin e prokurorisë që ata drejtojnë, sepse është edhe në funksion të raportimit vjetor që

bën prokurori i Përgjithshëm dhe për masën dhe mënyrën e zbatimit të nxjerra nga prokurori i Përgjithshëm. Tani, nxjerr udhëzime dhe nuk ka asnjë raportim mbrapa... Besojmë se janë dy elemente.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Faleminderit për mirëkuptimin!

Neni 44.

**Vexhi Muçmataj** – Kam një koment për nenin 44.

**Fatmir Xhafaj** – Ke konflikt interesi?

**Vexhi Muçmataj** – Germa “ç” e nenit 44 verifikon përfundimin e çështjeve dhe, kur është e nevojshme, udhëzon kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale. Çfarë ndodh në praktikë te germa “ç” e nenit 44? Në praktikë ndodh që prokurorë të caktuar zvarrisin në mënyrë të pajustificuar çështje penale ose marrin zgjatje pa shkaqe të arsyeshme. Do të thosha se duhet bërë një rregullim: “Verifikon ecurinë dhe përfundimin e çështjeve dhe, kur është e nevojshme, udhëzojnë kryerjen e detyrave”. Pra, ecuria e hetimeve është shumë e rëndësishme.

**Fatmir Xhafaj** – Zoti Xholi, urdhëroni!

**Adnan Xholi** – Jam dakord me zotin Muçmataj.

**Vehbi Muçmataj** – Po kështu, udhëzojnë me shkrim, jo thjesht me gojë. Pra, akti të mbetet në dosje.

**Fatmir Xhafaj** – Zoti Xholi, urdhëroni!

**Adnan Xholi** – Të njëjtin mendim kemi me zotin Muçmataj, sepse në praktikë ka shumë zvarritje të pajustificuara të hetimeve dhe, nëse në këtë moment drejtuesi i prokurorisë nuk kontrollon ecurinë e hetimeve, atëherë do të zgjaten pafundësisht afatet. Është e domosdoshme edhe ecuria e hetimit dhe urdhri të jepet me shkrim.

**Artan Hoxha** – Ka një vërejtje edhe nga ne dhe përputhet me atë që tha zoti Muçmataj, që të bëhet me shkrim. Ne themi se duhet të verifikohet ecuria e çështjeve dhe e mbyllim fjalinë “sipas përcaktimeve të nenit 49, që rregullon te mënyra se si udhëzohet për çështje konkrete.

**Vexhi Muçmataj** – Neni 49 bën fjalë për udhëzime konkrete, që nuk janë të detyrueshme. Këtu është rast specifik dhe mendoj se duhet përjashtuar nga udhëzimet jo të detyrueshme. Është rast i veçantë që ka të bëjë me ushtrimin e ndjekjes penale.

Ndërsa këtu bëhet fjalë për udhëzime jo të detyrueshme, ai mund t’i zbatojë, mund të mos i zbatojë.

**Artan Hoxha** - Më duhet të bëj një shpjegim. Udhëzimet e detyrueshme janë të karakterit të përgjithshëm, që mund t'i lëshojë prokurori i Përgjithshëm dhe prokurori titullar, sipas rastit. Udhëzimet jo të detyrueshme janë për çështje konkrete, lëshohen me shkrim dhe prokurori që e ka çështjen i përgjigjet po me shkrim mosndjekjes së tyre. Nuk kemi tri lloje udhëzimesh.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, por bëheni me shkrim, që të jetë e qartë.

**Artan Hoxha** - Është te neni 49 me shkrim.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, por bëheni edhe këtu!

**Vexhi Muçmataj** – Kjo nuk është efektive.

**Fatmir Xhafaj** - Ramë dakord se do ta themi...

**Artan Hoxha** - Këto dy kategori kemi, nuk kemi ...

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Vexhi Mucmataj** - Unë mendoj se ky është një rast i veçantë dhe duhet konsideruar si i tillë.

**Fatmir Xhafaj** – Po, pra, do ta bëjmë me shkrim dhe në proces. Pse ta zgjasim kot?

**Oerd Bylykbashi** – Zoti kryetar, sugjerimi ynë është që te fjalia e fundit, dhe do të kërkoja vëmendjen e ekspertëve, të saktësohet kjo kompetencë, pra të saktësohet fakti që kjo kompetencë i përket edhe prokurorit të Përgjithshëm, por prokurorit pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Do të doja mendimin e prokurorisë së Përgjithshme dhe të ekspertëve në lidhje me këtë. Pra, kjo kompetencë i përket edhe prokurorit të Përgjithshëm, pranë prokurorisë së Përgjithshme. Çfarë mendohet në lidhje me këtë?

**Artan Hoxha** – Detyrimisht që i përket, por kemi një dispozitë në nenin 2...

**Fatmir Xhafaj** – Për çështje konkrete?

**Artan Hoxha** – Jo, jo, kur flasim se kush është prokurori. Në nenin 2, kur bëjmë përkufizimet, themi se çfarë kuptojmë me “prokurorë më të lartë” dhe çfarë kuptojmë me “prokurorë titullarë” dhe është koncepti për të gjithë. Për Prokurorinë e Përgjithshme është prokurori i Përgjithshëm, kurse për secilën prokurori është prokurori i njesisë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, atëherë. Miratohet me ndryshimin që bëmë.

Neni 45: “Zëvendësdrejtuuesi i prokurorisë”.

**Ulsi Manja** - Dakord.

**Fatmir Xhafaj** - Neni 46: “Pavarësia procedurale e prokurorëve”.

**Ulsi Manja** - Dakord.

**Fatmir Xhafaj** - Neni 47: “Udhëzimet e përgjithshme të detyrueshme”.

Po, zoti Bylykbashi.

**Oerd Bylykbashi** – Kemi diçka.

Në pikën 4 të thuhet: “Ndër qëllimet që ndjekin udhëzimet e përgjithshme të drejtuesit të prokurorisë është edhe lehtësimi i zbatimit të udhëzimeve të nxjerra nga prokurori i Përgjithshëm”, pra ka një propozim aty. Çfarë mendoni për të?

**Artan Hoxha** – Mund të shtohet kjo fjali. Ne e diskutuam dhe thamë: “Drejtuesit e prokurorisë mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme për çështje të organizimit dhe të funksionimit të prokurorisë që drejtojnë, si dhe për lehtësimin e zbatimit të udhëzimeve të prokurorit të Përgjithshëm sipas nenit 44 të këtij ligji”.

**Fatmir Xhafaj** – A mund të sjellë probleme kjo, sepse mund të bëjë një riinterpretim të drejtuesit të prokurorisë poshtë udhëzimit të përgjithshëm të prokurorit, pra mund të ketë ndonjë problem?

**Artan Hoxha** – Mund të konstatoj që nuk ka vijueshmëri; nuk ka zbatim jokorrekt, sepse nuk ka të bëjë me çështje konkrete.

**Fatmir Xhafaj** – Mirë, por pa prekur thelbin, sepse ai mund të bëjë një interpretim të vetë.

**Artan Hoxha** – Kur themi: “...pas nenit 44..”

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Adnan Xholi** – Thjesht vijueshmërinë kërkuam, pra zgjatja e afatit të hetimeve është ecuria e hetimeve që ka të bëjë me shkeljen e të drejtave të njeriut. Nëse një prokuror i Shkallës së Parë nuk e bën, dhe biem dakord me zotën Muçmata për pjesën që udhëzimet do të jenë me shkrim dhe duhet të jenë të detyrueshme jo për çështje konkrete; zgjatja e afatit nuk është për çështje konkrete, sepse thuhet: “Nuk e miratoj zgjatjen e afatit. Përfundojeni çështjen brenda kësaj periudhe ose ta miratojmë për një javë, por jo për tre muaj”.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord të “Udhëzimet e përgjithshme të detyrueshme” me ndërhyrjen që u bë.

Neni 48: “Kundërshtimi i udhëzimeve të përgjithshme”.

Dakord.

Neni 49: “Udhëzimet jo të detyrueshme për çështje konkrete”.

Po, zoti Rakipi.

**Vexhi Muçmataj** – Unë kam diçka, për ta bërë më të zbatueshme atë që diskutuam te neni 44. Them se mund të ndërhyjmë këtu te pika 2, pra fjalia: “Udhëzimet për çështje konkrete nuk mund të përmbajnë udhëzime të detajuara për mënyrën...”, të hiqet dhe të themi: “...nuk mund të përmbajnë udhëzime të detajuara për mënyrën e procedimit apo që ndikojnë mbi prokurorin e çështjes në lidhje me vlerësimin e tij” dhe...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, nuk është përsëritje, por po ta shkurtojmë, nuk cenohet ajo që thamë te neni 44. Nuk di a më kuptuat, zoti kryetar?

**Fatmir Xhafaj** – Jo.

**Vexhi Muçmataj** – Pra, po sqaroj: “Udhëzimet për çështjet konkrete”, heqim fjalinë: “...nuk janë të detyrueshme”, dhe vendosim: “nuk mund të përmbajnë udhëzime të detajuara për mënyrën e procedimit apo që ndikojnë mbi prokurorin e çështjes në lidhje me vlerësimin e tij”.

**Fatmir Xhafaj** – Kjo ia humbet kuptimin asaj, sepse në çfarëdolloj versioni mund të mos përmbajë udhëzime të detyruara, mund të jenë edhe të përgjithshme, por nuk janë as të detyrueshme; qenia jo të detyrueshme është e rëndësishme, pavarësisht nga natyra e udhëzimit.

**Vexhi Muçmataj** – Nuk po kuptohemi.

Thashë: “Udhëzimet për çështjet konkrete nuk janë të detyrueshme dhe nuk mund të përmbajnë udhëzime të detajuara për mënyrën e procesit ...”. Pra, heqim disa rreshta dhe i lëmë hapësirë ...

**Fatmir Xhafaj** - Jo, mendova se thatë heqim edhe këtë: “...nuk janë të detyrueshme”.  
Më fal!

**Vexhi Muçmataj** – Dhe i lëmë hapësirë asaj që thamë te neni 44.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

“Udhëzimet për çështjet konkrete nuk janë të detyrueshme” dhe vazhdojmë pastaj: “...nuk mund të përmbajnë...”

**Fatmir Xhafaj** – Pra, shprehja: “...kufizon dhënien e orientimeve për zgjidhjen e problemeve të natyrës së përgjithshme” hiqet, për të mos pasur mbivendosje. Kjo është logjika.

**Vexhi Muçmataj** – “...dhe nuk mund të përmbajnë udhëzime të detajuara për mënyrën e procedimit”, pra “...nuk janë të lira, kufizohen” hiqet. Kaq.

**Ulsi Manja** - Duhet riformuluar pak në kuptimin që t’i lëmë hapësirë neni 44.

**Fatmir Xhafaj** – Shikojeni të lidhur me të. Në qoftë se cenohen...

**Vexhi Muçmataj** – Pra, me një fjalë: “Udhëzimet nuk janë të detyrueshme për mënyrën e përfundimit të çështjes ose që të ndikojnë në përfundimin e çështjes”, ndërsa hapësira të krijohet për të dhënë udhëzime për ecurinë e hetimeve.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 50: “Zëvendësimi i prokurorit”.

**Oerd Bylykbashi** – Ne kemi ngritur një shqetësim për pikën 2, në lidhje me zëvendësimin e prokurorit për shkak se ai është i paaftë për punë, sepse në gjykimin tonë është një hipotezë që rrezikon abuzimin në praktikë, për ndërhyrje të papërshtatshme. Çështja e aftësisë profesionale është çështje e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, pra ai mund të marrë vendim dhe ta zëvendësojë, për rrjedhojë mund të ndikojë në një çështje konkrete.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk e thotë atë gjë. Thuhet: “...për shkak të mungesës ose të paftësisë së tij për punë”.

**Vexhi Muçmataj** – Pra, të thuhet: “Prokurori ka të drejtë të paraqesë ankim me shkrim kundër vendimit të zëvendësimit”. U do ta paraqesë këtë ankim, kujt duhet t’ia paraqesë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Arben Rakipi** - Ka qenë në projektet e para, por këtu nuk e shoh. Ndoshta do të jetë ndonjë gabim i sekretarisë që e ka fshirë.

Ne po flasim për disa nene në mënyrë të tërthortë lidhur me cenimin e pavarësisë së prokurorit. Kemi arritur në pikën që po vëmë në dyshim nenin 46 ose sistemin e ri që jemi duke ndërtuar, sepse kemi gjithë ato mekanizma, të cilat cenojnë pavarësisë e prokurorit. Përmenda një dispozitë, që nuk po e shoh, e cila ka qenë dispozita e vetme që ne kishim menduar fillimisht për të rregulluar këtë çështje, çka do të thotë që frikën e madhe që kemi pasur për shpërbërjen e sistemit ose për adoptimin e sistemit të ri lidhur me faktin se sa të përgjegjshëm do të ishin individët, prokurat e veçantë për të ushtruar aq mirë detyrën e tyre sa e ushtron prokurori i Përgjithshëm. Pra, kishim arritur në një zgjidhje, e cila ishte kjo që, kur flasim për prokurorin më të lartë, në eventualitetin që prokurori i çështjes nuk punon, zvarrit hetimet në mënyrë të paarsyeshme, nuk e pushon ose nuk e dërgon çështjen në gjyq, përtej asaj që konsiderohet nga jeta “e arsyeshme”, atëherë prokurori i lartë ndërhynte, e merrte vetë çështjen, nuk ia kalonte prokurorit tjetër, siç përmendet te neni 50, sepse kalimi te prokurori tjetër rrëzon decentralizimin dhe ngreh tjetër çështje, por e merrte vetë. Kjo ishte zgjidhja për të cilën ne kishim rënë dakord që ky sistem ri i mund të rregullohej. Tani nuk e shoh; nuk e di se si ka rrëshqitur kjo çështje, por

më duket se është një element për të mbajtur sistemin nga ana e titullarit. Mirë do të ishte që neni 50 të riformulohet edhe me këtë shqetësim timin.

**Fatmir Xhafaj** – Atë po diskutojmë edhe ne këtu. Kjo ka sens, sepse ndryshe pastaj kthehemi ...

*(Diskutime e pa mikrofon)*

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, unë kam një sugjerim te neni 50. Ju i referoheni një neni konkret në Kodin e Procedurës Penale, kur ne ende nuk e dimë renditjen e neneve dhe nëse ai nen do të përmbajë pikërisht kushtet e pazgjidhshmërisë. A nuk është më mirë të themi...

**Fatmir Xhafaj** – Pra, sipas Kodit të Procedurës Penale.

**Vasilika Hysi** – E dyta, dhe këtë e kam në përgjithësi për të gjithë vazhdimësinë e ligjit, sepse ne kemi ligjin “Për statusin e gjyqtarit dhe të prokurorit”; kemi ligjin “Për qeverisjen” dhe duhet të unifikojmë edhe gjuhën, edhe rregullat, edhe standardet në të tria këto ligje.

**Fatmir Xhafaj** – Ramë dakord që neni 50 të riformulohet, pra jemi të gjithë dakord me propozimin e zotit Rakipi.

Dakord me riformulimin e nenit 50.

Neni 51: “Raportimi vjetor te prokurori i Përgjithshëm”.

**Ulsi Manja** - Dakord.

**Fatmir Xhafaj** - Neni 52: “Shmangia e konfliktit të interesit”

**Ulsi Manja** - Dakord.

**Fatmir Xhafaj** - Neni 53: “Drejtimi administrativ i prokurorisë”.

**Ulsi Manja** - Dakord.

**Fatmir Xhafaj** - Neni 54: “Shpërndarja e çështjeve”.

**Ulsi Manja** - Dakord.

**Fatmir Xhafaj** - Neni 55: “Mbledhja e prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Po, të themi: “...brenda 3-mujorit” dhe ai le ta ngushtojë vetë pastaj, me statistikat, me të gjitha.

**Oerd Bylykbashi** – Në paragrafin 13, kur bëjmë komentin për nenin 43, ka një paragraf tjetër që flet për shkurtimin e afateve, pra afatin për raportimin te prokurori i Përgjithshëm në muajin janar, në mënyrë që ai të përgatitet për në mars.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Po e kaluam më parë, por ne e kemi lidhur këtu me nenin 51, por nga që ecëm pak më shpejt, na kaloj. Pra, si e gjykoni të organizohet kjo, pra që ata të kenë kohën e mjaftueshme, por edhe prokurori i përgjithshëm të jetë në gjendje për ta përgatitur raportin.

**Artan Hoxha** – Pikërisht pra, se në qershor dolëm, sepse do të mbaroj viti dhe këto nuk i kemi ne, i kemi më tepër nga prokuroria sesa nga vetja dhe ata do të kenë një kohë që të interpretojnë secilin informacionin ...

**Fatmir Xhafaj** – Pra, “brenda 3-mujorit të parë”, pastaj se e bën në janar, se e bën në shkurt, e organizon vetë ai.

**Artan Hoxha** – Deri në 3-mujorin e parë, ai mund ta bëjë.

**Fatmir Xhafaj** – Pra, 3- mujorit të parë të vitit. Kaq dhe ta mbyllë vetë ai procesin.

**Artan Hoxha** – Nëse ne do t’i ngushtojmë kohën, për shembull, brenda shkurtit atë tjetrin ta nxjerrim brenda marsit, nuk do të jetë kohë e mjaftueshme.

**Adnan Xholi** – Nuk është e mundur, sepse këto bien në kundërshtim me njëra tjetrën. Brenda muajit mars duhet të raportojë prokurori i Përgjithshëm, kurse brenda...

**Fatmir Xhafaj** – Prandaj, po them brenda 3-mujorit të parë.

**Arben Rakipi** – Pra, duhet rregulluar të paktën periudha që prokurorët e prokurorisë së Shkallës së Parë deri në shkurt ose deri në fund të janarit të kenë përfunduar, që t’u lihet minimalisht 2 muaj kohë për të përgatitur raportin dhe për ta depozituar.

**Fatmir Xhafaj** – Po, dakord, pra rregullojeni brenda 60 ditëve dhe biem dakord.

Neni 55: “Mbledhja e prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme”.

**Ulsi Manja** - Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 56: “Mbledhja e prokurorëve të prokurorive të tjera”.

**Ulsi Manja** - Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 57: “Zhvillimi dhe procedura e mbledhjes së prokurorëve”.

**Ulsi Manja** - Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 58: “Organizimi i administratës së prokurorisë”.

**Artan Hoxha** – Te neni 58 kemi diçka, pra themi: “Veprimtaritë që duhet të kryhen rregullisht për secilin nga këto shërbime përcaktohen në rregulloren standard të organizimit dhe të funksionimit të prokurorisë, të miratuar nga prokurori i Përgjithshëm ose nga drejtuesit e tjerë të prokurorisë, që janë drejtuesit, përfshi SPAKU-n, përfshi ...

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, u kuptuam.



Dakord me nenin 58, me ndryshimin. Keni të drejtë.

Neni 59: “Kancelari”

**Ulsi Manja** - Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Unë kam diçka këtu: kancelar dhe sekretar i Përgjithshëm. Kancelari i prokurorisë dhe sekretari i Përgjithshëm ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pastaj, keni thënë që ka sekretar të Përgjithshëm edhe te SPAKU. Nuk ka, sepse ne e kaluam ligjin. Ia jepni ju këtu, por nuk ia ka dhënë ai atje. A mund të ketë edhe kancelar, edhe sekretar të Përgjithshëm në një godinë?

**Artan Hoxha** – Kancelari është i Prokurorisë së Përgjithshme.

**Fatmir Xhafaj** – Ose kancelar, ose sekretar i Përgjithshëm.

**Adnan Xholi** – Prokuroria e Përgjithshme ka sekretar.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, por kancelar mund të jetë edhe ai i prokurorit të Përgjithshëm. I njëjti funksion është, nuk është ...,

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Edhe kancelar, edhe sekretar i Përgjithshëm nuk mund të rrinë në një godinë. Pra, t’i rregullojmë, t’i bashkojmë kompetencat.

**Adnan Xholi** – Duhet të jetë në union; ose kancelar, ose sekretar në të gjitha shkallët e prokurorive.

**Fatmir Xhafaj** – Keni vënë kancelar te SPAKU, kancelar në të gjitha nivelet, sekretar i Përgjithshëm këtu, ngatërrohet.

Pra, neni 59.

**Korajlka Bumci** – *(flet përkthyesi)* Si u la, do ta lëmë sekretarin e Përgjithshëm, apo jo?

**Fatmir Xhafaj** – Nuk mund të ketë edhe kancelar, edhe sekretar të Përgjithshëm, një figurë administrative do të ketë.

**Korajlka Bumci** – *(flet përkthyesi)* Atëherë, duhen bërë disa ndryshime në dispozitat transitorë.

**Oerd Bylykbashi** – Kam një pyetje për ekspertët: Pse e keni parashikuar të ndarë. Ata kompetencat i kanë të ndryshme, por përse keni parashikuar që të jenë dy figura, që të gjykojmë a do t’i bashkojmë apo t’i lëmë ve?

**Korajlka Bumci** – *(flet përkthyesi)* Kemi kancelarë për çdo degë të prokurorisë.

**Fatmir Xhafaj** – Kancelarët i kanë në degë, sekretarin e Përgjithshëm e kanë lart; kanë dy emra të ndryshëm. Kjo është logjika.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Por, kancelar është edhe ky.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, pra, njësoj është.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, pra, të ministrive. Sekretari i Përgjithshëm i Kryeministrisë ka ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mos bëni shpikje! Kancelari i prokurorisë ka kompetencën.

**Keltis Kruja** – Ne mund të bëjmë një unifikim të emërtesës së administratës, sepse do të kemi problem pastaj. Në qoftë se mendojmë se mund të ketë problem...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kancelari i prokurorisë së Përgjithshme, sigurisht që i ka në varësi të gjithë kancelarët e tjerë. Nuk besoj se ka ndonjë ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të gjitha institucionet shtetërore kanë sekretar të Përgjithshëm. Nuk mund të diferencohet.

**Fatmir Xhafaj** – Gjithë sistemi gjyqësor punon me kancelarë; edhe sistemi i prokurorisë punon me kancelar; edhe sot në gjykata kancelarë janë, edhe në prokurori ka kancelarë. Tani këtë doni ta quani “shef stafi” dhe i vini emrin sekretar i Përgjithshëm...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kancelari i Përgjigjëm, kaq; një emër mund të ketë, nuk mund të ketë dy emra.

**Artan Hoxha** – Do ta shohim te neni 67, sepse po e themi tani.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, këtu kemi 59-ën, kancelarin e prokurorisë së Shkallës së Parë dhe të Shkallës së Dytë, apo jo?

**Artan Hoxha** – Këtu kemi kancelarët pa prokurorin e Përgjithshëm.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Keni gjë për kancelarin, pa prokurorinë e Përgjithshme? Nuk keni.

Neni 60: “Sekretaria e prokurorisë”.

**Ulsi Manja** - Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 61: “Marrëdhëniet me publikun”.

**Ulsi Manja** - Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Ne kemi rënë dakord që në çdo prokurori do të kishte një person të ngarkuar, një prokuror të ngarkuar për marrëdhëniet me publikun. Nuk e gjej në këtë. Te SPAKU e realizuam.

**Ulsi Manja** – Edhe te paragrafi i dytë thuhet: “...kryhen nga një prokuror i caktuar për marrëdhëniet me publikun ose në mbikëqyrjen e këtij të fundit”, 61/2.

**Fatmir Xhafaj** – Jo, këtu është fjala kur janë në prokurori të Përgjithshme.

Tani, a mund të vendosni aty që pranë prokurorive të caktohet një prokuror për marrëdhëniet me publikun, siç keni bërë për gjykatat, për të gjitha.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Tani, unë mund të mos e kem parë me vëmendje. Unë e di që nuk e keni, sepse e kam lexuar ligjin deri në fund, por ndoshta...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, por thuhet: “Shërbimet e marrëdhënieve me publikun kryhen nga një prokuror i caktuar për marrëdhëniet me publikun ose nën mbikëqyrjen e këtij të fundit, pra prezumon që...”

**Artan Hoxha** – Thuhet “Kryhen nga ai ose në mbikëqyrjen e tij”.

**Fatmir Xhafaj** – A ka mundësi ta detajoni që prokuroritë gjyqësore kanë një prokuror, i cili merret me këtë gjë, sepse ata nuk kanë as zëdhënia, kurse ky ka shërbim për marrëdhëniet me publikun, pra prokuroria e Përgjithshme ka zyrë.

**Artan Hoxha** – Të themi: “...në mënyrë më të drejtpërdrejtë”

**Fatmir Xhafaj** – Pra, ta ketë ai drejtpërdrejtë; çdo prokurori ka një prokuror, siç kemi bërë te SPAKU, siç kemi bërë me gjykatat dhe kështu rrisim transparencën.

Dakord për 61, me riformulimin e bërë.

Neni 62: “Teknologjia e informacionit”.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 63: “Arkivat e prokurorisë”

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 64: “Rendi dhe siguria në prokurori”

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 65.

Po, zoti Bylykbashi.

**Oerd Bylykbashi** – Ne kemi një vërejtje.

Nenet 65 dhe 72 kanë të njëjtën përmbajtje, kështu që ose do të bjerë neni 72 ose do të

...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Artan Hoxha** – Dakord, do t'i riformulojnë nenet 65 dhe 72 dhe do t'i bëjnë një dispozitë.

**Fatmir Xhafaj** - Dakord.

Neni 66: “Struktura e Prokurorisë së Përgjithshme”

**Ulsi Manja** - Dakord.

**Fatmir Xhafaj** - Neni 67 “Sekretari i Përgjithshëm”.

**Vexhi Muçmataj** – A mund të bëj një koment?

Unë mendoj se emërtimi “Sekretar i Përgjithshëm” duhet të qëndrojë për faktin se të gjitha institucionet qendrore që kanë kompetencë kombëtare këtë emërtim kanë. Edhe Gjykata Kushtetuese nuk ka kancelar, por ka sekretar të Përgjithshëm. Të gjitha institucionet shtetërore emërtimin e kanë ...

**Fatmir Xhafaj** – Edhe Gjykata e Lartë ashtu e ka?

**Vexhi Muçmataj** – Përmenda Gjykatën Kushtetuese.

**Fatmir Xhafaj** – Po Gjykata e Lartë?

**Vexhi Muçmataj** – Gjykata e Lartë është shkallë gjykimi, nuk është si Gjykata Kushtetuese. Është një gjykatë më e lartë gjykimi sesa Gjykata e Apelit, por nuk ka juridiksion kombëtar, siç ka Gjykata Kushtetuese, pra është shkallë gjykimi.

**Fatmir Xhafaj** – Si nuk ka juridiksion kombëtar?!

**Vexhi Muçmataj** – Ka diferencë; është një shkallë gjykimi.

**Artan Hoxha** – Është te ligji “Për shërbimin publik”, që është një ligj i përgjithshëm që i referon të gjithë, madje përmend edhe Prokurorinë e Përgjithshme.

**Vexhi Muçmataj** – Bëra thjesht një koment.

Kam edhe diçka tjetër, që nuk është specifikuar këtu: cilat janë kriteret e përzgjedhjes së sekretarit të Përgjithshëm?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mirë, por duhet ta referojmë në ligjin përkatës.

**Artan Hoxha** – Dua të bëj një sqarim, nëse mundem.

Në ligjin aktual “Për prokurorinë” është pranuar ligji “Për shërbimin civil”. Kjo është futur edhe në organizimin gjyqësor, që do të thotë se të gjitha rregullat që aplikohen për përzgjedhjen e nëpunësve të shërbimit civil aplikohen edhe për këta që janë të prokurorisë, kështu që ne nuk krijojmë rregullat reja, sepse ato janë.

**Fatmir Xhafaj** – Është e unifikuar atje. Kjo është një nga risitë e gjithë kësaj reformë.

**Artan Hoxha** - Është edhe një garanci që nuk lëvizet sipas lëvizjes së prokurorëve, titullarëve e kështu me radhë.

**Fatmir Xhafaj** - Neni 67: “Sekretari i Përgjithshëm”, jemi dakord.

Neni 68: “Sektorët e ekspertizës”.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 69.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 70: “Prokurorët e komanduar në Prokurorinë e Përgjithshme”.

**Vexhi Muçmataj** – Më fal pak tek ekspertiza, zoti kryetar.

Këtu bëhet fjalë për të ngritur seksione ose struktura ekspertize pranë çdo prokurorie. Mendoj se nuk është e përshtatshme, për arsyen e thjeshtë se duke qenë pranë një prokurorie ata krijojnë marrëdhënie të afërta me prokurorët, marrëdhënie njohjeje, të cilat mund të ndikojnë tek ekspertiza, prandaj mendoj që sektori i Ekspertizës duhet të jetë i përqendruar në Prokurorinë e Përgjithshme.

**Fatmir Xhafaj** – Në qoftë se ka një ekspert për vrasje e për të tilla, ai mund të ketë...

**Vexhi Muçmataj** – Jo, për vrasje ka laboratorë. Këtu bëhet fjalë për ekspertime, jo për vrasje, bëhet fjalë për ekspertime të natyrave të tjera.

**Fatmir Xhafaj** – Prandaj thuhet: “Mund të ngrihen dhe të funksionojnë sektorët e ekspertizës që kanë...”, sepse ai do të shkojë në vendngjarje me...

**Vexhi Muçmataj** – Në vendngjarje shkon prokurori, shkon oficeri i i Policisë Gjyqësore, shkon Policia Shkencore.

**Fatmir Xhafaj** – Mirë, por ka edhe ky ekspertët e vet, që...

**Vexhi Muçmataj** – Ekspertët e vet, por duke qenë brenda prokurorive krijohen marrëdhënie të afërta, marrëdhënie që nesër mund të ndikojnë në gjykim.

**Fatmir Xhafaj** – Por, si t'i krijojmë? Si t'i bëjmë ekspertë, t'i mbajmë në Tiranë të gjithë?

**Vexhi Muçmataj** – Të përqendruar në prokurorinë e Përgjithshme.

**Fatmir Xhafaj** – Nga këtu do të shkojë në Sarandë ai?

**Vexhi Muçmataj** – Kur shkohet në një vendngjarje thërriten edhe ekspertë privatë, edhe ekspertë të qarkullimit rrugor, edhe ekspertë të fushave të ndryshme, ekspertë të kriminalistikë, të cilët janë persona zyrtarë, por që të krijosh pranë çdo prokurorie seksione ekspertize, unë e konsideroj të papërshtatshme.

**Oerd Bylykbashi** – Thuhet: “Pranë prokurorive mund të ngrihen dhe të funksionojnë sektorët e ekspertizës”. Kjo është posibilibet, çka do të thotë se çmohet sipas rastit, sipas nevojave. Nëse ecim me idenë që do të jetë pranë çdo prokurorie, do të kemi...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo domosdoshmërisht, është mundësi, por çmohet për t'u ngritur. Pyetja që më lind është: kush e ngreh, sepse thuhet: “Mund të ngrihet”, pra kush e ka kompetencën për këtë?

**Fatmir Xhafaj** – Kemi thënë që në fillim fare që strukturën e prokurorisë e bën prokurori i Përgjithshëm, “kur është e nevojshme. Unë do t'i jap këtij dy njerëz”, thotë prokurori, është në strukturë.

**Oerd Bylykbashi** – Dhe e zgjidh këtë gjë?

**Fatmir Xhafaj** – Po, patjetër.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Artan Hoxha** - Paragrafi i 5-të e ka një përgjigje, zoti Bylykbashi, kur thuhet: “Këshilli i Ministrave e parashikon këtë edhe për ngritjen bazuar në kërkesat e prokurorive”.

**Fatmir Xhafaj** – Të mos merremi me këtë gjë.

**Artan Hoxha** – Prokuroria vetë ka nevojë. Mund të ketë edhe rregulla të brendshme prokuroria se si funksionon.

**Oerd Bylykbashi** – Atëherë, e thonë tërthorazi. Unë e kuptoj, pastaj ajo gjen zbatim në praktikë. Çështjen e ngrita më tepër për saktësinë e dispozitës, por kjo lexohet edhe në mënyrë tërthore; ka nen tjetër, ka pikën 5 dhe e kuptojmë që ka për ta bërë prokurori i Përgjithshëm. Pastaj, çështja që ngiti zoti Muçmata është çështje tjetër.

**Vexhi Muçmataj** – Po të mendohet se në të gjitha rrethet do të ketë ekspertë, është e papranueshme, për arsye sepse në Sarandë, sepse u bë fjalë për Sarandën, si mund të kesh, për shembull, një numër ekspertësh në Sarandë, që të rrinë kot, të paguhen kot.

**Fatmir Xhafaj** – Nëse do të jetë e nevojshme do të shkojnë, se nuk e lë njeri të rrijë kot. Po ta ketë të nevojshme do ta ngrejë, po nuk e pati të nevojshme nuk do ta ngrejë.

**Vexhi Muçmataj** – Është pa kuptim.

**Ulsi Manja** – Me leje, zoti kryetar!

Ne duhet t'i japim një zgjidhje këtij problemi, sepse problemi i ekspertizës në prokurori, sidomos i pagesave të ekspertëve ka qenë gangrenë; është sëmundje gati 20-vjeçare në prokurorinë shqiptare. Shërbimi i ekspertizës është aksesor shumë i rëndësishëm për hetimin. Tani, çështja shtrohet nëse ka efektivitet të jenë pranë prokurorisë shërbimet e ekspertizës apo të vazhdohet me këtë thirrjen e ekspertëve të jashtëm, siç ka vazhduar praktika deri më tani, është çështje tjetër, por, gjithsesi, në fund të fundit, prokurori akuzë ngre. Edhe sipas Kodit të Procedurës Penale, subjektet e hetimit kanë të drejtën e kundërshtimit të ekspertit në rast se krijohet kjo lidhje, që mund të krijohet normalisht, por përderisa është vendim që palët mund ta kundërshtojnë, mua më duhet që me këtë ligj ne duhet të zgjidhim problemin e ekspertizës. Hetimi nuk duhet të pengohet për këtë lloj shërbimi, sepse sot prokuroria vuan nga ekspertët, sepse nuk ofrohen për shkak të mospagesë, ekspertët nuk paguhen; nuk ta ofrojnë shërbimin.

**Adnan Xholi** – Ngritja e sektorit të ekspertizës pranë çdo lloj prokurorie është e domosdoshme, për shkak se mund t'ju them edhe një rast konkret: ekspertët autoteknik, të cilët mund të merren nga jashtë për numrin e aksidenteve që ndodhin në Shqipëri, faturën financiare e kanë shumë më të lartë sesa një eksperti t'i japësh një rrogë sipas kushteve për statusin e nëpunësit civil dhe përfundohet akti i ekspertimit paraprak para caktimit "masë sigurimi". Duke filluar nga Saranda në Tropojë është e domosdoshme prania e këtyre ekspertëve pranë institucioneve, pra nëse është e domosdoshme, sepse në disa raste e kemi që nuk shkon eksperti në vendngjarje dhe dështon çështja, duhet vetëm të përcaktohen kriteret se kush do t'i përzgjedhë këta ekspertë, sepse është lënë evazive.

**Vexhi Muçmataj** – Për veprat penale në fushën e qarkullimit, kjo është e zgjidhur, sepse pranë çdo rrethi ka shërbime të Policisë Rrugore dhe ata janë të specializuar ...

**Fatmir Xhafaj** – Ka nevojë për ekspertiza të tjera. Krimi tani po bëhet më i sofistikuar; të ketë prokurori i ekspertizës pozitive, këtë unë nuk e kuptoj.

**Adnan Xholi** – Janë shkrirë dhe ka vetëm dy ekspertë për të gjithë Shqipërinë.

**Korajlka Bumci** – *(flet përkthyesi)* Zakonisht lidhet me fushën ekonomike, me ekspertë të fushës ekonomike jo thjesht rrugore.

**Adnan Xholi** – Edhe për prokurorinë e Posaçme duhen ekspertët kontabël...

**Fatmir Xhafaj** – Ata i kemi vendosur.

**Adnan Xholi** – Është e njëjta strukturë që do të përdoret për hetimet, pra duhen ekspertët ..

**Fatmir Xhafaj** – Vetëm ka një gjë këtu. Kanë të drejtë zoti Manja dhe zoti Muçmata, ndoshta këtu duhen specifikuar rregulloret, udhëzimet, kush i miraton. Ndoshta i duhen lënë këshillit, që të jenë të qarta këto, që të evitohen konfliktet e interesit. A mund të vendosim një paragraf aty, që këshilli përcakton rregulla të hollësishme për përzgjedhjen. A mund ta bëjmë një gjë të tillë për shërbimet e ekspertizës, zoti Rakipi?

**Arben Rakipi** - Këtë çështje sa më shumë ta diskutosh aq më shumë komplikohet, sepse nëse shihet nga pikëpamje procedurale do të dalim në shqetësimin e drejtë të zotit Muçmataj që nuk duhet ta ketë prokurori ekspertin me vete, sepse është i njëanshëm. Po ta shohësh nga pikëpamja administrative do të dalë pyetja: po këta çfarë duan? Pse do të flasim ne për ekspertët? Pra, ideja jonë ka qenë që në prokurori duhet të jetë një grup specialistësh, të cilët të jenë këshilltarë të prokurorit për degë të caktuara të shkencës. Tani, ndoshta i kemi quajtur në mënyrë të sforcuar “ekspertë”, por unë bashkohem me zotin Muçmataj që ndoshta nuk duhet të jenë të tillë, por këtë qëllim kanë, çka do të thotë që janë ata, të cilët bëjnë një lloj mbikëqyrje mbi ekspertimet e tjetërkujt, i japin prokurorit disa të dhëna paraprake për atë që ai duhet të pyesë ekspertët, ku duhet ta zgjerojë hetimin e kështu me radhë, domethënë këta janë këshilltarë që nëse pastaj janë të pajisur me teknikë, siç thotë dispozita, aq më mirë akoma, por nëse propozimi...

**Fatmir Xhafaj** – A mund të na bëni një riformulim ku të ruhet edhe shqetësimi i drejtë i zoti Muçmataj dhe nevojën që kanë, që thotë zoti Xholi.

**Arben Rakipi** – Nëse do t’i ndërrojmë titullin për mua përputhet me të gjithë...

**Fatmir Xhafaj** – A mund të na i përputhni këto të dyja?

**Arben Rakipi** – Duke thënë pak a shumë “këshilltarë teknikë”.

**Fatmir Xhafaj** – Pra, biem dakord “asistencë teknike”, “këshillimi teknik” ose thjesht “ekspertiza”. Pra, a mund të na bëni një riformulim që të mos cenohet kjo gjë?



**Artan Hoxha** – Kjo që thotë zoti Rakipi është që sa më tepër të hysh aq më shumë hapet situata. Kjo është njëra ide, por është edhe ideja tjetër që ata shërbejnë edhe si ekspertë nëse nuk ka kundërshti, nëse palët pranojnë.

**Fatmir Xhafaj** – Ju lutem, a bëni një debat me njëri-tjetrin dhe ta zgjidhni, se ne nuk jemi ekspertë...

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Artan Hoxha** – Teknike është, por kthehet në thelbësore më pas, prandaj dhe i kemi rënë kështu pak si ...

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Shikojeni dhe zgjidheni këtë gjë!

Neni 69.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 70.

**Vexhi Muçmataj** – Këtu kisha diçka. Unë mendoj se nuk duhen prokurorët e komanduar në Prokurorinë e Përgjithshme. Qëllimi sipas pikës 2 del për të bërë relacione, për të këshilluar prokurorët që do të shkojnë pranë Gjykatës së Lartë për të përfaqësuar çështjen. A është e nevojshme kjo?

**Fatmir Xhafaj** – Po, sepse në një moment të caktuar prokuroria mund të ketë nevojë për forca shtesë, sepse do të bëjë studime për gjendjen e kriminalitetit, do të ketë nevojë të marrë magjistratë për...

**Vexhi Muçmataj** – Jo.

**Fatmir Xhafaj** – Po, që t'i ketë këshilltarë prokurori i Përgjithshëm.

**Vexhi Muçmataj** - Thuhet: "...përgatit relacionin për çështje të objektit të gjykimit në Gjykatën Kushtetuese, në Gjykatën e Lartë, ..."

**Fatmir Xhafaj** – Po e sqaroj: nuk do të ketë më këshilltarë pa Shkollë Magjistrature dhe vetvetiu ai është prokurorë në detyrë. Ai e merr dhe krijon njësinë dhe komandon për 3-4 vjet ..

**Vexhi Muçmataj** – Pse duhet të jetë i komanduar?

**Fatmir Xhafaj** – Sepse aq nevojë ka. Në një moment të caktuar mund të ketë nevojë për 2-3 shtesa. Ku qëndron e keqja?

**Vexhi Muçmataj** – Për mua është e panevojshme dhe e papërshtatshme.

**Artan Hoxha** – Janë këta ndihmesat pranë Prokurorisë së Përgjithshme, që, sipas ligjit për statusin quhen prokurorë të komanduar, sepse duan t’u japin disa funksione më shumë. Kjo dispozitë për ne është marrë nga ligji “Për statusin e nëpunësit civil”, pra ndryshon terminologjia; janë ndihmësit pranë prokurorit të Përgjithshëm.

**Fatmir Xhafaj** – Është njësoj sikur të vëmë në status...

**Artan Hoxha** – Pra, në Prokurorinë e Përgjithshme. Këta nuk quhen më “ndihmesa”, por quhen “prokurorë të komanduar”, u japin një nivel pak më të lartë dhe u japin këto funksione që kanë, por duhet parë ligji “Për statusin e nëpunësit civil”.

**Vexhi Muçmataj** – Po insisto, sepse pranë prokurorit të Përgjithshëm ka një strukturë të prokurorëve, që përfaqësojnë çështjet në Gjykatë të Lartë, pra ka një strukturë, që quhet Drejtoria Gjyqësore, ku janë prokurorët e emëruar. Pse duhet të çojmë edhe prokurorët e komanduar brenda kësaj strukture?

**Adnan Xholi** – Është tjetër gjë të thuash “ndihmës” ose “këshilltar” dhe është tjetër gjë të thuash “prokurorë të komanduar”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mendoj se është i domosdoshëm shtimi dhe krijimi i kësaj strukture për shkak se ndihmësit ligjor do të riformatohen, do të hiqen dhe do të jenë prokurorët e komanduar ose ndihmësit ligjor.

Te pika 3, kam diçka tjetër aty ku thuhet: “...në vlerësimin e punës së prokurorëve të komanduar kryer nga drejtuesi i prokurorisë”. Mendoj se duhet të bëjmë një rregullim, sepse këta mund të jenë të emëruar në prokurorinë iks dhe punën e kryejnë pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe vlerësimin do ta bëjë drejtuesi i Prokurorisë së Përgjithshëm, pra të thuhet: “vlerësimin e bën prokurori i Përgjithshëm, drejtuesi ose shefi i sektorit përkatës, sepse ai e ka në varësi gjatë asaj periudhe rekomandimi”.

**Fatmir Xhafaj** – Duhet të keni parasysh, për shembull, Ministria e Drejtësisë do të vijë momenti që do të ketë nevojë për kapacitete shtesë, pra nuk i përballon dot. Ai nuk mund të marrë në një moment kur do të ketë 10 ligje për të bërë, nuk mund të marrë disa punonjës dhe pas 5 vjetësh ata nuk kanë çfarë të bëjnë. Ai thith burime të tjera, merr prokurorë, gjyqtarë që të punojnë për një ligj të caktuar, siç ndodh në të gjithë botën. Në Itali magjistratët shkojnë në Ministrinë e Drejtësisë dhe kur ai shkon 50-60 vjeç shërben në Ministrinë e Drejtësisë, i shërben

ministrit të Drejtësisë si forcë e kualifikuar, por ai është magjistrat në thelb, pra përfiton të gjitha të drejtat e një magjistrati, por i jep mundësinë atij që të ketë shërbime shtesë.

**Petrit Vasili** – Ligji i shërbimi civil që i referohen ka një problem, sepse vendet vakante janë për të plotësuar vakancën ..

**Fatmir Xhafaj** – Jo, nuk jemi te vendet vakante.

**Petrit Vasili** – Jo desha të dal te koncepti “i komanduar”.

Përdoret në mënyra të ndryshme koncepti atje dhe këtu. Në ligjin e shërbimit civil ka vende vakante dhe për të mbuluar vakancën deri në hapjen e procedurave urdhërohet komandimi i një njeriu për të bërë punën, ndërsa këta janë në punë e sipër. Kjo është me fjalë të tjera: si do të riorganizohemi kur kemi prioritete. Por a mund të vësh në ligj se si do të riorganizohemi, kur ne mund të kemi një ngjarje, larg qoftë, shumë të madhe dhe të mblidhen të gjitha prokuroritë, kjo do t’i pengojë. Atëherë, me urdhra të brendshme të prokurorit...

**Fatmir Xhafaj** – Jo, ka diçka, sepse ai e ka me status, nuk shkon; është ndryshe nga punonjësi civil. Nëse nuk e komandon këshilli ai nuk shkon, thotë: “Nuk dua të shkoj”.

**Petrit Vasili** – Por ka udhëzime të brendshme. Ju thatë që janë edhe “të detyrueshme, jo të detyrueshme”. Ne po ngremë këtu, duam nuk duam, një tjetër piramidë. Ne nuk po ngremë prokurori principata, që nuk ka lidhje me këtë gjë dhe nuk kanë një politikë, kjo sipas meje. Ne e shikojmë si një trupë organike, që funksionon në këtë pikë.

**Fatmir Xhafaj** – Po, zoti Xholi.

**Adnan Xholi** – Është e pamundur që të operohet me udhëzim, sepse këta prokurorë nuk e kanë statusin për të shkuar në Prokurori të Përgjithshme dhe është e detyrueshme që komandimi i magjistratëve të bëhet në këtë lloj forme...

**Fatmir Xhafaj** – Pra, të jetë e parashikuar në ligj.

**Adnan Xholi** – Po, sepse për të shkuar prokuror nga Shkalla e Parë në Prokurori të Përgjithshme, nuk mund të komandohet nga poshtë-lart me cilësinë e prokurorit, kurse më cilësinë e ndihmësit ose magjistratët patjetër që mundet.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me nenin 70, me sugjerimin që u bë.

**Artan Hoxha** – Për nenin 70 nuk ka sugjerim, sepse duhet të kuptohemi që ajo që tha Xhoni, në fakt, ne flasim për prokurorë të komanduar në Prokurori të Përgjithshme dhe rregullimi i nenit 3 thotë: “Vlerësimi i punës së prokurorëve të komanduar kryhet nga drejtuesi i

prokurorisë”, që është prokurori i Përgjithshëm, “bazuar në mendimin e dhënë nga prokurori pranë të cilit punon”, kështu që nuk ka çfarë të rregullohet këtu.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 71.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 72.

**Ulsi Manja** – Neni 72 do të bashkohet me nenin 65.

**Fatmir Xhafaj** – Po, ishte vërejtja e zotit Bylykbashi.

Neni 73: “Formimi profesional”.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 74: ‘ Vlerësimi kualifikues për kancelarë”.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 75.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 76.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 77.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 78.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 79.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 80.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 81.

Po, zoti Bylykbashi.

**Oerd Bylykbashi** - Te neni 81 kemi një sugjerim që te pika 3, fraza “shërbimi civil gjyqësor” të zëvendësohet me frazën “shërbimi gjyqësor i prokurorisë”. Ekspertët le ta gjykojnë.

**Ulsi Manja** – Prokuroria nuk mund të ketë shërbim gjyqësor. I kemi vënë vizë fjalës “gjyqësor”, ngelet vetëm ambienti civil.

**Artan Hoxha** – “Gjyqësor” ka ngelur nga gjykata. I kemi hequr “gjyqësor” dhe themi “shërbimi civil”.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 82.

**Korajlka Bumci** – (*flet përkthyesi*) Te neni 82, paragrafi 6 pas fjalëve “Prokurori e Përgjithshme” do të jenë edhe fjalët “Prokuroria e Posaçme”.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 83.

**Korajlka Bumci** – (*flet përkthyesi*) Të njëjtën gjë edhe te neni 83, paragrafi 5.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 84.

**Adnan Xholi** – Te neni 84, sepse thuhet: “Kancelari i çdo prokurorie...” për shkak se administrata e Prokurorisë së Përgjithshme ka sekretarin e Përgjithshëm dhe duhet të shtohet se kush do të mbajë dosjet përkatëse, pasi drejtor personeli nuk do të ketë.

(*Ndërhyrje pa mikrofon*)

Sekretari i Përgjithshëm për Prokurorinë e Përgjithshme dhe kancelari për ...

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 85.

**Oerd Bylykbashi** – Te neni 85 kemi një vërejtje te pika 20 ku thuhet: “Te pika 4 teksti i shkronjës “a” është i paqartë kur vendos rregullin për njësimin e skemës së pagës me atë të kategorive përkatëse të nëpunësit civil”, sepse nuk kuptohet se cila është kategoria përkatëse. Kjo është vërejtja.

**Artan Hoxha** – Vërejtja është e drejtë. Referenca është te “nëpunësi civil gjyqësor”. Pra, referenca është te paga e nëpunësve civilë gjyqësorë, pra duhen shtuar fjalët “nëpunësit civilë gjyqësor”.

**Oerd Bylykbashi** – Kam edhe diçka teknike po te kjo fjali. Pas fjalëve: “ritjen pagave për punonjësit civilë” ka një pikëpresje aty.

**Artan Hoxha** – Te germa “b”?

**Oerd Bylykbashi** – Jo, te germa “a”. Thjesht është diçka që ma zuri syri, një pikëpresje ndoshta është e gabuar dhe mund të sjellë interpretim të gabuar.

**Artan Hoxha** – Po, duhet presje.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 85, me ndryshimin që u tha te pika 4 “a” dhe te pika 5.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 86.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 87.

**Ulsi Manja** – Dakord.

*(Vazhdohet me të njëjtën procedurë deri te neni 98)*

**Fatmir Xhafaj** - Neni 99: “E drejta për ankim”

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 100: “Regjistrimet disiplinore”.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 101: Ndërprerja e marrëdhënieve të shërbimit civil prokurorisë”

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 102.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 103.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 104: “Marrëdhëniet me Këshillin e Ministrave”.

**Oerd Bylykbashi** – Te neni 104 sugjerojmë të caktohet përmbajtja e pikës 2, sepse thjesht dhënia e informacionit për ndryshimet në buxhet është e pamjaftueshme. Pra, të thuhet: “I përket prokurorit të Përgjithshëm, organit që ai drejton, të analizojë dhe të zbërthejë në marrje masash rekomandimin e dhënë, që nënkupton se duhet të jetë kjo strukturë që përcakton ndryshimet e nevojshme të buxhetit, me qëllim reflektimin e rekomandimeve”.

**Fatmir Xhafaj** – Ku është kjo te neni 104?

*(Diskutime pa mikrofon).*

**Petrit Vasili** - Desha të di pse përdorimin termin “mbledhje publike të Këshillit të Ministrave”, çfarë do të thotë kjo? Pra, thuhet “...në një mbledhje publike të përbashkët”, këto janë terma pa kuptim. Të thuhet në mbledhjen e Këshillit të Ministrave dhe kaq mjafton.

**Artan Hoxha** - Ideja është debat publik për një interes...

**Fatmir Xhafaj** – Mos devijoni... Kushtetuta ka të drejtë. A keni ndonjë gjë për nenin 104?

**Oerd Bylykbashi** – Ajo do të mbetet, por unë do të doja komentimin e ekspertëve në lidhje me atë që referojnë ekspertët tanë. Pra, saktësimin e pikës 2 dhe, gjithashtu, çështjen që shtrohet në lidhje me pikën 5. Në formulimin e pikës 5 thuhet:” Këshilli i Ministrave nëpërmjet Ministrisë të Drejtësisë ndjek në vazhdimësi mënyrën e zbatimit dhe të rekomandimeve të dhëna prej tij”, duket sikur në këndvështrimin tonë gjë që e ngritëm edhe te çështjet kryesore, i jep një mundësi ministrit të Drejtësisë dhe mund të interpretohet që ai mund të inspektojë punën e ...

**Fatmir Xhafaj** – Jo, nuk lexohet kështu.

**Oerd Bylykbashi** – Ne ngremë këtë shqetësim dhe unë do të doja këndvështrimin e ekspertëve në lidhje me këtë çështje.

**Petrit Vasili** – Këtë shqetësim e kam ngritur unë në mbledhjen e radhës së shkuar dhe në qoftë se ka një politikë të qeverisë, kemi pranuar pikën 4 për ta rekomanduar, për të marrë informacionin e duhur se si kjo politikë e qeverisë, atëherë të mbahej në informacion. Pavarësia e garantuar e sistemit është absolute, por transmetimi i politikave dhe informacioni i ndërsjellë është thjesht në normalitet, është minimumi i komunikimit.

**Oerd Bylykbashi** – Prokurori i Përgjithshëm ka detyrimin të raportojë në Kuvend dhe në momentin kur ne i japim mundësinë ministrit të Drejtësisë që ai të shkojë dhe ta ndjekë se si po zbatohet dhe nëse ai me këtë do t’i japë të drejtë vetes...

**Fatmir Xhafaj** – Merr informacion.

**Oerd Bylykbashi** – Po nuk thotë që merr informacion.

**Fatmir Xhafaj** – Ai do ta ndjekë se si do të zbatohen rekomandimet, ka përgjegjësi për këtë.

**Oerd Bylykbashi** – Po të njëjtën gjë bëjnë edhe ata prokurorët, ndjekin zbatimin e rekomandimeve. Pra, kjo mund të interpretohet si një e drejtë e ministrit për të inspektuar punën e prokurorisë, prandaj në këndvështrimin tonë kjo duhet hequr, sepse krijon probleme me Kushtetutën.

**Fatmir Xhafaj** – Nuk krijon probleme me Kushtetutën.

**Petrit Vasili** – Rekomandimet?

**Fatmir Xhafaj** – Po rekomandime janë në thelb.

**Petrit Vasili** – Rekomandime është te pika 3...

**Fatmir Xhafaj** – Pika 2 do të lexohet, Jonida. “Rekomandimet miratohen në mbledhjen e Këshillit të Ministrave” dhe pikë. “Rekomandimet duhet të përmbajnë informacion edhe për ndryshimet e buxhetit që janë të nevojshme për realizimin e tyre dhe ministri i Drejtësisë e ndjek këtë”. Në rregull.

**Oerd Bylykbashi** – Dakord, por kjo mund t’i japi...

**Fatmir Xhafaj** – Madje, unë jam që në lidhje me pjesën ku thotë: “të jetë jo më vonë se data 31”, kjo gjë duhet saktësuar, sepse fjalia nuk mund të fillojë me jo më vonë. Pra, duhet të jetë: Këshilli i Ministrave përmes ministrit të Drejtësisë, sepse vjen Kryeministri dhe thotë: Jo, nuk do ta çojë ky ministër, por do ta çojë ministri për Marrëdhëniet me Parlamentin apo ministri i Brendshëm. Jo, përmes ministrit të Drejtësisë.

**Oerd Bylykbashi** – Zoti kryetar, ne sugjerojmë...

**Fatmir Xhafaj** – E keni këtë rezervë ju gjithmonë...

**Oerd Bylykbashi** - ... që kjo pikë të hiqet. Po të njëjtën gjë kërkojmë edhe për pikën 2 të nenit 108 dhe kur të vijmë te kjo pikë ta diskutojmë.

**Fatmir Xhafaj** - Dakord.

**Artan Hoxha** – Zoti kryetar, duhet ta rishikoni të lidhur me nenin 108, sepse në këtë nen thuhet: ministri i Drejtësisë e paraqet buxhetin, e ka më pas.

**Fatmir Xhafaj** – Rekomandimet prioritare, dakord.

**Artan Hoxha** – Ne kemi pasur parasysh vërejtjet e zotit Vasili...

**Fatmir Xhafaj** – Në lidhje me nenin 105 “Marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë”.

A keni ndonjë gjë?

**Adnan Xholi** – Unë besoj se duhet të shtohet te pika 3 e nenit 105: “Nuk mund të bëj raportime për çështje konkrete, të cilat janë në hetim. Është e ndaluar që të raportohet për çështjet në hetim”.

**Fatmir Xhafaj** – Po, sigurisht e do. Te pika 3 e nenit 105, jo për çështje konkrete.

**Adnan Xholi** – Pra, duhet shtuar “jo për çështje konkrete dhe në hetim”.

**Fatmir Xhafaj** – Mua m’u duk sikur e lexova.

**Adnan Xholi** – Nuk ishte atje ku duhet, mund të jetë diku tjetër, por te kjo dispozitë..

**Fatmir Xhafaj** – Atëherë, shiheni dhe në qoftë se nuk është vendoseni. Gjithsesi, është pozitive për ta theksuar të jemi realist. Bëni një riformulim.



**Ulsi Manja** – Bëni një riformulim të pikës 3 të nenit 105 që të dalë saktësisht që prokurori i Përgjithshëm nuk raporton për çështje konkrete para Kuvendit.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull.

Neni 106 “Marrëdhëniet me Këshillin e Lartë të Prokurorisë”. Dakord?

**Ulsi Manja** - Po.

**Fatmir Xhafaj** - Neni 107 “Marrëdhëniet me inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Dakord?

**Ulsi Manja** - Po.

**Fatmir Xhafaj** - Neni 108 “Marrëdhëniet me ministrin e Drejtësisë”.

Zoti Bylykbashi, ka vërejtje.

**Oerd Bylykbashi** – Siç e përmenda edhe pak më parë ne nuk jemi dakord me formulimin dhe kërkojmë që të hiqet pika 2 e nenit 108, për të njëjtin arsyetim që dhashë në lidhje me pikën 5 të nenit 104.

**Fatmir Xhafaj** – Si të hiqet?

**Oerd Bylykbashi** – Ky është sugjerimi që bëjmë ne.

**Fatmir Xhafaj** - Që të depozitohet për një periudhë ankesat që paraqiten kundër prokurorëve?

Më fal një minutë! Në qoftë se qytetarët i dërgojnë ministrit të Drejtësisë ankesat, çfarë të bëjë ai t’i mbajë? Ai vetë nuk ka inspektorat, as atë nuk e ka...

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Në pikën 2 thuhet: Ia përcjell ankesat dhe i depoziton pranë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë? Çfarë të bëjë ministri i Drejtësisë?

**Fatmir Xhafaj** – Për mua jo vetëm kaq, por t’i ndjekë ato.

**Oerd Bylykbashi** – A keni Inspektorat të Lartë të Drejtësisë, a ka ankesa atje? Pra, a mund të dërgohen atje ankesat?

**Fatmir Xhafaj** – Po, i shkojnë ministrit.

**Oerd Bylykbashi** – Po, të shkojnë edhe te Kryeministri dhe t’i dërgoi ai atje. Ka edhe te Gjykata Kushtetuese dhe t’i dërgojmë atje ankesa dhe kjo më pas ajo t’ia çojë...

**Fatmir Xhafaj** – Ministrit të Drejtësisë, por nuk është... Kryeministri në qoftë se ka diçka ia përcjell ministrit të Drejtësisë, po ashtu edhe ministri i Brendshëm në qoftë se ka diçka ia përcjell ministrit të Drejtësisë, kështu funksionon shteti.

**Oerd Bylykbashi** – Në lidhje me nenin 104, i japim kompetenca inspektuese ministrit të Drejtësisë, atë që ia hoqëm.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Ju tani këtë doni, ta mbani si kazus, por e keni gabim, sepse nuk ka inspektim. Pra, ia çon, më vijnë mua si ministër i drejtësisë ankesat. Zoti Bumçi, a ju vinin juve ankesa, apo jo? A mund t'i përcjellësh...?

*(Diskutime pa mikrofon)*

Në kushtet që nuk ke inspektorat çfarë do të bësh më...

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Petrit Vasili** – Zoti Xhafaj, më falni pak, a do të bëjmë bisedë serioze? Oerd, të diskutojmë ne në lidhje me pjesën që ka detyrimin ta depozitohet dhe të bëjmë debat. A e dini pse duhet hequr kjo? Kjo duhet hequr se është qesharake, për këtë dhe jo se ka ndonjë rrezik...

*(Mungesë incizimi)*

**Ulsi Manja** – Kalojmë te neni 109?

**Fatmir Xhafaj** – Ministri i Drejtësisë është avokati i qytetarëve...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Është parimore që ministri i Drejtësisë të ketë një rol aktiv në këtë proces.

Po, zoti Rakipi.

**Arben Rakipi** – Me këtë shprehje kemi dashur të themi që ministri i Drejtësisë nuk ka kompetenca për procedimin disiplinor.

**Fatmir Xhafaj** – Kjo është e qartë, sepse i kemi hequr kompetencat, por edhe këtë do t'ia heqim tani?

**Arben Rakipi** – Ai nuk mund të paraqitet më si ankues në KLP as në KLGJ, vetëm thjesht të bëjë transportin e ankesës...

**Fatmir Xhafaj** – Është minimumi i gjësë që ka, për mua.

Neni 108 “Marrëdhëniet me ministrin e Drejtësisë”. Dakord?

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** - Neni 109 “Marrëdhëniet me Policinë Gjyqësore”. Dakord?

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 110 “Dispozita kalimtare për prokurorët dhe ndihmësit ligjorë në detyrë”.

**Ulsi Manja** – Dakord.

Neni 111 “Dispozita kalimtare për sekretarin e Përgjithshëm dhe kancelarin”. Dakord.

Neni 112 “Dispozita kalimtare për persona në detyrë në Drejtorinë e Inspektimit dhe të Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme”. Dakord.

Neni 113 “Dispozita të veçanta për nëpunësit civilë dhe punonjësit në prokurorinë e posaçme”. Dakord.

**Fatmir Xhafaj** - Neni 114.

**Ulsi Manja** – Po.

**Adnan Xholi** – Te neni 114, besoj se paragrafi 2, pozicioni aktual në gjykatë, duhet të ndryshohet në prokurori. Pra, edukimin dhe pozicion aktual në gjykatë, duhet të bëhet në prokurori.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Ka të drejtë zoti Xholi.

Jeni dakord me nenin 114 bashkë me ndërhyrjet? Po.

Neni 115.

**Oerd Bylykbashi** – Kisha diçka këtu. Në nenin 115 thuhet “miraton aktet brenda afatit”. Cili është afati?

*(Diskutime pa mikrofon)*

Të hiqet fare nga formulimi.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Pas fjalës “ligj”.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, e heqim.

Dakord me ndryshimin e propozuar nga zoti Bylykbashi.

**Oerd Bylykbashi** – Përpara se të shkojmë te neni 116, ne ngritëm çështjen e një dispozite tranzitore për Këshillin e Lartë të Prokurorisë të çështjet...

**Fatmir Xhafaj** – Më fal që po ta them, por e ke te ligji që do të miratohet “Për Këshillin e Lartë të Prokurorisë”.

**Oerd Bylykbashi** – Do ta rregullojmë atje me dispozitat tranzitore...

**Fatmir Xhafaj** – Po, patjetër! Këtu nuk ke asnjë...

Neni 116. Dakord.

Neni 117 “Hyrja në fuqi”. Dakord?

**Ulsi Manja** – Dakord.

Më fal, zoti Xholi!

**Adnan Xholi** – Nëse është e mundur, për shkak edhe të polemikave që janë krijuar kohët e fundit, siç është operuar edhe dje për ligjin e SPAK-ut, do të kërkonim që në lidhje me nenin 39, të parashikohet sërish një dispozitë kalimtare për kompetencat e prokurorit të Përgjithshëm që deri në fillimin dhe funksionimin e institucioneve të reja kushtetuese siç janë KLP-ja dhe Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, të vijojnë kompetencat sikundër janë dhe në ligjin aktual “Për prokurorinë”.

**Fatmir Xhafaj** – Ai e ka atë, nuk mund të bëjë një gjë...

*(Diskutime pa mikrofon)*

E bën për çështjet për hetimin...

**Adnan Xholi** – Pikërisht këtë kërkojmë ne.

**Fatmir Xhafaj** – Ai ka kompetencat kushtetuese..

**Adnan Xholi** – Ne e kemi mëse të qartë që i ka këto kompetenca, por, siç është për institucionet të parashikohet dhe në këtë ligj se si do të vijohet më tutje.

**Fatmir Xhafaj** – Po e ka, sepse ai vazhdon detyrën...

**Adnan Xholi** – Nuk po thotë kush që nuk e vazhdon detyrën...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Pikërisht, meqë jemi në këtë moment dhe po krijohet ky ligj të parashikohet që do të vijojë deri në...

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Fatmir Xhafaj** – Nuk ka si të ndryshojë sistemi, çfarë do të ndryshoj në sistem?

**Artan Hoxha** – Do të ishte dispozitë jokushtetuese. Në qoftë se do i thuash prokurorit të Përgjithshëm se do të vazhdosh kompetencat që ke me ligjin aktual, ndërkohë që miratohet ky ligj, e para nuk ka kuptim. Deri sa të krijohet Këshilli i Lartë i Prokurorisë prapë nuk ka kuptim, sepse prokurori i Përgjithshëm sot edhe pa këto ligje, të vetmin problem që mund të ketë është ai i juridiksionit dhe jo problem funksional, sepse problemi funksional ka rënë me Kushtetutën. Nëse Kushtetuta thotë se emërimin, transferimin, disiplinimin e ka Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk mund t’i thuash për një ligj që do ta vazhdojë prokurori i Përgjithshëm atë funksion që ka pasur përpara në Kushtetutë.

**Fatmir Xhafaj** – Ndërkohë që ti miraton ligjin e ri, se po të mos e kishe miratuar ligjin e ri...

**Artan Hoxha** – Plus që po miratohet edhe ky ligj dhe në momentin që miratohet nuk ka më efekt ligji i mëparshëm, sepse shfuqizohet në nenin e fundit të këtij ligji.

**Oerd Bylykbashi** – Kemi dy momente: momentin e miratimit të ligjit dhe hyrjes në fuqi, që do të na japë rregullimet për Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe kemi faktin që është ngritja e organit. Pra, deri në ngritjen e organit duhet t’i ushtrojë dikush ato kompetenca dhe nëse këtu nuk thuhet se kush do t’i bëjë...

**Fatmir Xhafaj** – Në Gjykatën Kushtetuese... do të zbatojë Kushtetutën.

**Oerd Bylykbashi** – Po nuk e patëm këtë regjim tranzitor ne mund të mbetemi përsëri në të njëjtin ngërç. Nuk jemi duke folur për juridiksionin, por po flasim për ato kompetencat e tjera që nesër do t’i bëjë Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe sot nuk i bën dot prokurori i Përgjithshëm, sepse Këshilli i Lartë i Prokurorisë u ngrit me ligj, por nuk është faktikisht.

**Fatmir Xhafaj** – Kur të shkojmë te Këshilli do të flasim për këto gjëra.

**Oerd Bylykbashi** – Unë nuk e shoh këtu problemin e kushtetutshmërisë, por kam problemin e ngërçit, sepse do të jenë kompetenca që prokurori i Përgjithshëm tani nuk do t’i ushtrojë dot.

**Artan Hoxha** – Po bëjmë një bisedë kolegësh dhe kisha diçka si specialist. Pra, sot prokurori i Përgjithshëm nuk ka funksionet, sot me Kushtetutë dhe nuk jam duke folur për ato që i japim ne me ligj. Pra, me Kushtetutë, pavarësisht se është ngritur një organ, nuk do të thotë që funksionet e këtij organi që ia ka dhënë Kushtetuta, derisa nuk është ngritur ky funksion t’i ushtrojë një tjetër që nuk i ka. Kjo dispozitë do të ishte haptasi në kundërshtim me Kushtetutën.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull.

**Artan Hoxha** – Mosngritja e këtij organi nuk të legjitimon të marrësh funksionet e këtij organi, sepse Kushtetuta e ka përcaktuar se kush është disiplinimi dhe karriera, kush e ka në dorë, pavarësisht se nuk është ngritur si organ. Ti mund të kesh një periudhë tranzitore, por kjo nuk krijon asnjë lloj problemi në funksionimin e institucionit. Diskutimi i vetëm është çështja e kompetencës funksionale jo institucionale, pra çështjet e juridiksionit dhe të kompetencës. Ndërsa t’i thuash sot prokurorit të Përgjithshëm që do të vazhdosh funksionet deri sa të krijohet organi tjetër është e gabuar.

**Oerd Bylykbashi** – Unë nuk ndaj të njëjtin mendim, që të jemi të ndershëm me njëri-tjetrin. Ne jemi këtu dhe gjëja më e rëndësishme është se duhet të garantojmë që këto organe kushtetuese të ushtrojnë ato detyra që janë për t'u ushtruar. Unë nuk e di se kur do të ngrihet Këshilli i Lartë i Prokurorisë, di sot dhe po e parashikoj, por se kur do t'i ushtrojë funksionet këtë nuk e di. Deri atëherë duhet të jenë disa detyra që duhet t'i bëjë ajo kur të ngrihet dhe sot kjo nuk bëhet, prandaj pikërisht për këtë shërbejnë dispozitat tranzitore.

Po ju jap një shembull shumë të thjeshtë. Në vitin 2003 ndërruam një regjim total, i cili në fund të fundit garantonte një të drejtë kushtetuese, hartimin e listave të zgjedhësve. Pra, nga një regjim ligjor në një regjim tjetër dhe vetëm se nuk kishte një dispozitë tranzitore organi kushtetues i kohës që rregullonte, nuk e merrte përsipër zbatimin me pasojën e cenimit të të drejtave të individëve. Procedura ishin këto dhe do të kryente veprime. Pra, në qoftë se ne nuk do të garantojmë këtë tranzicion për këtë periudhë që mund të jetë një javë, mund të jetë 2 javë, mund të jetë 3 muaj, atëherë ne do të ndeshemi me probleme, përderisa ngrihet ky problem. Unë besoj se gabojmë në momentin kur vëmë Kushtetutën përpara për të zgjidhur një problem që do të jetë nesër praktik. E përsëris se nuk ndaj të njëjtin mendim që do të ishim përpara një shkeljeje të Kushtetutës, sepse po i japim kompetencë një organi që nuk e paska më me Kushtetutë, ndërkohë që organi tjetër që do ta kryejë këtë në momentin kur është ngritur, nuk është ngritur ende. Në këtë mënyrë do të krijojmë boshllëk në ushtrimin e kompetencave kushtetuese që në fund të fundit i duhen sistemit dhe nuk ka rëndësi nëse e ka iksi apo ipsiloni. Kush do t'i kryejë këto në këtë periudhë?

**Fatmir Xhafaj** – Shqetësimi që ne kemi për hetimin e zgjidhëm. Pra, çështjet në hetim nuk kanë më pengesa dhe është çështja themelore për funksionalitetin. A keni ndonjë gjë tjetër?

**Oerd Bylykbashi** – E njëjta logjikë është edhe për hetimin.

**Vexhi Muçmataj**– Ka edhe një dispozitë kalimtare këtu, neni 112, që thotë: “Personat në detyrë në Drejtorinë e Inspektimit dhe të Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji konsiderohen të komanduar pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në rastin e prokurorëve apo të transferuar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë në rastin e nëpunësit civil...”

**Fatmir Xhafaj** – Edhe ju këtë po thoni që është zgjidhur.

**Vexhi Muçmataj** – Po, neni 112. Ndërsa në lidhje me anën funksionale nuk preket asgjë.

**Fatmir Xhafaj** – Jeni dakord me hyrjen në fuqi, 15 ditë.

A ka ndonjë gjë tjetër?

Jeni dakord në tërësi? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit!

Reflektoni të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet për të cilat ramë dakord.

Ditën e hënë është shqyrtimi i projektligjit “Për qeverisjen e gjyqësorit”, këshillat...

**Oerd Bylykbashi** – Zoti kryetar, gjithsesi mbeten çështjet sistemike që ne ngritëm dhe pasojat që ato do të prodhojnë. Sigurisht, janë përgjegjësi e atyre që mendojnë se ky sistem do të prodhojë ndjekje penale, efikase në të ardhmen.

Ju lutem, mos u largoni!

**Fatmir Xhafaj** – Mbledhja për sot mbyllet.

Faleminderit kolegëve!

Falënderoj zonjën Bumçi, zotin Hoxha, zotin Rakipi, zotin Xholi. Falënderoj ekipin e Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe ekipin tonë të sekretariatit teknik, Jonidën, Mozën dhe përkthyesit për kontributin e tyre.

Ju faleminderit të gjithëve!

## **MBYLLET MBLEDHJA**

*Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga stafi teknik i angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë*

